



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Kontabilitet dhe Auditim”

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc.Dr. Ilir TOMORRI

Prof.Asoc.Dr. Klodian MUÇO

Mars / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Kontabilitetit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Msc “Kontabilitet dhe Auditim”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 510, datë 08.11.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASH nr.297, datë 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite / 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	23 PAE/15 PAK v.a. 2021-2022 18 PAE/13 PAK v.a. 2020-2021 14 PAE/17 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	103 Studentë v.a. 2021-2022 85 Studentë v.a. 2020-2021 71 Studentë v.a. 2019-2020
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës (përmendur në vijim me shkurtime UT) është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 207, datë 30.05.1957. UT-ja është akredituar me Vendim BA Nr. 84, datë 27.10.2018, me kohëzgjatjen 4 vite, nga data 27.10.2018 deri në 26.10.2022.

Universiteti i Tiranës (UT) është universiteti më i madh publik në vend i përbërë nga tetë njësi kryesore, të ndara në gjashtë fakultete dhe 2 institute kërkimore (Fakulteti i Ekonomisë; Fakulteti i Shkencave të Natyrës; Fakulteti i Gjuhëve të Huaja; Fakulteti i Drejtësisë; Fakulteti i Shkencave Shoqërore; Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë; Instituti i Studimeve Evropiane dhe Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar).

Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës (FEUT), përbëhet nga gjashtë departamente:

1. Departamenti i Ekonomiksit;
2. Departamenti i Financës;
3. Departamenti i Kontabilitetit;
4. Departamenti i Marketing-Turizmit;
5. Departamenti i Menaxhimit;
6. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar;

Ky fakultet ofron programe studimi në ciklin e parë të studimeve (Bachelor), ciklin e dytë të studimeve Master Profesional dhe Master i Shkencave dhe në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës. Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” ofrohet nga Departamenti i Kontabilitetit i Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës (UT). Ai është hapur me urdhërin e MASH Nr.510, datë 08.11.2010. Ky program studimi, realizohet me një kohëzgjatje 2 (dy) vite akademike me 120 kredite. Pranimi i studentëve që ndjekin këtë program studimi të ofruar nga Departamenti i Kontabilitetit pranë FEUT është realizuar sipas kriterëve të ligjit Nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i UT-së, Rregullorja e UT-së, Rregullorja e FEUT-së si dhe Rregullorja e programit të studimit. Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” ka si qëllim të ofroj studime të thelluara teorike dhe aftësi praktike në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, për ti pajisur studentët me njohuri të avancuara kërkimore-shkencore për karrierën e tyre të mëtejshme akademike dhe profesionale. Objektivat e këtij programi studimi janë: formimi i specialistëve të aftë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit në përputhje me sfidat e zhvillimit në vendin tonë. Pas përfundimit të studimeve, studenti pajiset me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme, për t’u punësuar si kontabilist, auditues, analist i pasqyrave financiare, etj., në institucione dhe organizata publike si dhe kompani apo biznese private. Gjithashtu, përfundimi me sukses i këtij programi studimi u mundëson studentëve të diplomuar, vazhdimin drejt një karriere të mëtejshme kërkimore dhe akademike për studimet e ciklit të tretë të doktoraturës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Kontabilitet dhe Auditim" në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës (FEUT), filloi me prezantimin dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga IAL dhe përgatitjen e raportit të vlerësimit të jashtëm.

Për këtë proces vlerësimi janë përzgjedhur si ekspertë të jashtëm: Prof. Asoc. Dr. Ilir Tomorri dhe Prof. Asoc. Dr. Klodian Muço të cilët, për realizimin e procesit të vlerësimit, u mbështetën në një seri dokumentash dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standartet dhe mënyrën e funksionimit të gjithë strukturave të (FEUT). Ky grup, bazuar në dokumentacionin e ngarkuar në portalin e ASCAL nga Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës (FEUT), filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj procedure u identifikuan dhe u listuan pyetje në lidhje me standartet dhe kritere përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës (FEUT) u realizua gjatë datave 04-05/10/2022, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shoqëruar nga eksperti i ASCAL-it Muhamed Prezja, të caktuar për këtë program studimi, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL.

Gjatë kësaj vizite 2- ditore, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Dekanin e FEUT-së; Përgjegjësin e Departamentit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të departamentit, studentët e këtij programi studimi si dhe vizitoi zyra të caktuara të këtij institucioni (Sekretarinë mësimore, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Dega e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Kurrikulave, etj) si dhe mjediset e FEUT (auditorët, laboratorët, biblioteka etj). Gjatë këtyre takimeve u shqyrtuan dhe u diskutuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e këtij programi studimi.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon raportin e vlerësimit të jashtëm tek eksperti përkatës i ASCAL.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 11.01.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 1/7 Prot, datë 11.01.2023. Universiteti i Tiranës më datë 23.02.2023, njofton nëpërmjet shkresës me nr. 3512/4 prot, datë 22.02.2023 "Mbi draft raportet e vlerësimit të jashtëm për programet e studimit master i shkencave në fakultetin e ekonomisë", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Referuar dokumentacionit të shqyrtuar (<i>Statuti i UT-së, Strategjia e zhvillimit të UT-së, 2018-2023</i>), GVJ konstatoi se Programi i ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”, ofruar nga Departamenti i Kontabilitetit të Fakulteti të Ekonomisë, i Universitetit Tiranës, është një program studimi që është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehur në planin strategjik të Universitetit të Tiranës 2018-2023. Ky program studimi nuk bie ndesh me interesat dhe strategjitë kombëtare të ekonomisë dhe zhvillimit të Arsimit të Lartë në vendin tonë. Nëpërmjet këtij program studimi synohet dhe mundësohet, përgatitja e specialistëve të rinj dhe të aftë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit në shërbim të interesave kombëtare. Ky program studimi, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 i ndryshuar dt. 22.09.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë. <i>Dok. (Statuti i UT-së; Strategjia e zhvillimit të UT-së, 2018-2023; Rregullore e UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit).</i>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave	Referuar dokumentacionit të ngarkuar në faqen e ASCAL, konkretisht Rregullores së Programit të Studimit GVJ konstaton se, Objektivat e programit të studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” janë: formimi i specialistëve të aftë në

<p>akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>ushtrimin e profesionit kontabel dhe për realizimin e studimeve të avancuara në fushën e kontabilitetit dhe auditimit në përputhje me objektivat dhe sfidat e zhvillimit të vendit tonë. Ky program studimi ka si qëllim përgatitjen e studentëve me njohuri të thelluara profesionale në fushën përkatëse, për kërkimin shkencor, nxitjen e një mendimi krijues dhe kritik dhe të pergjegjshëm në një shoqëri globale. Ky program studimi bazohet në legjislacionin në fuqi si dhe ruan dhe konsolidon vlerat akademike dhe kulturore dhe kombëtare.</p> <p><i>Dok. (Strategjia e zhvillimit të UT-së, 2018-2023; Statuti i UT-së; Rregullore e UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit).</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Referuar dokumentacionit lidhur me strategjinë e zhvillimit të institucionit rezulton se, Programi i ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”, ofruar nga Departamenti i Kontabilitetit të Fakulteti të Ekonomisë, është në përputhje me misionin dhe objektivat e Institucionit, të cilat janë të shprehur në planin strategjik të Universitetit të Tiranës 2018-2023. Pajisja e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe ato praktike nëpërmjet disiplinave përkatëse të këtij program e bën më të lehtë punësimin e tyre në tregun e punës. Programi i studimit është konkurrues në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkak të elementëve përbërës të tij si plani mësimor/ kurrikula, programet e lëndëve, metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve sipas njohurive të fituara, etj.</p> <p><i>Dok. (Strategjia e Zhvillimit të UT, 2018-2023; Statuti i UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit).</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>GVJ referuar shqyrtimit të Rregullores së Programit të Studimit, konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” synon t’u japë studentëve një edukim cilësor dhe të qëndrueshëm; të harmonizojë njohuritë teorike me ato praktike për të inkurajuar dhe formuar tek studentët përmes këtij programi studimi mendimin krijues dhe kritik si specialist të ardhshëm në fushën e Kontabilitetit dhe Auditimit. Referuar listës së marrëveshjeve GVJ, konstaton se Departamenti i Kontabilitetit bashkëpunon me një sërë institucionesh dhe organizma profesionale si KKK, IKM, SHFKSH, KLSH si dhe subjekte të ndryshme private, ku studentët kryejnë praktikatat profesionale ka evidentuar kërkesat e tyre të vazhdueshme për specialistë në fushën e kontabilitetit, auditimit, analistë të pasyrave financiare</p>

	<p>etj. Ky program është hartuar bazuar në studimin e tregut të punës së UT-së në vitin 2018 dhe pyetsorin e përgatitur nga Departamenti i Kontabilitetit për mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas, rajonal apo ndërkombëtar.</p> <p><i>Dok. (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015-2020; Rregullore e Programit të Studimit; Marreveshje bashkepunimi me KLSH, IKM, SHKFSH; Studimi i tregut të punës_UT-së, 2018; Pyetësor, lidhur me punesimin e studenteve, pas perfundimit të studimeve_DK 2022).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Programi i studimit i ofruar nga Departamenti i Kontabilitetit i FEUT, fokusohet në mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, dhe është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehur në planin strategjik të UT-së. Gjithashtu referuar strategjive të zhvillimit në nivel kombëtar, rajonal dhe më gjerë, ky program studimi synon rritjen dhe qëndrueshmërinë e kapacitetit të burimeve njerëzore, rritjen e nivelit të shërbimeve me interes publik në përputhje me direktivat e BE-së. Njohuritë e fituara nga ky program studimi u mundësojnë studentëve vazhdimin drejt një karriere kërkimore dhe akademike me qëllim ndjekjen e studimeve të thelluara në ciklin e tretë të doktoraturës.</p> <p><i>Dok. (Statuti i UT-së; Strategjia e Zhvillimit të UT, 2018-2023; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.2

Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”, është hartuar në përputhje të plotë me planin strategjik të zhvillimit të UT-së. Ky program ka të përcaktuara objektiva të qartë, të realizueshem dhe në përputhje me strategjinë e institucionit. Ai synon pajisjen e studentëve me njohuri dhe shprehje profesionale drejt të menduarit kritik dhe të aftë për tregun e punës.</p>

	<i>Dok. (Strategjia e zhvillimit të UT, 2018-2023; Statuti i UT-së; Rregullore e Programit të Studimit).</i>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	GVJ, duke analizuar dokumentat strategjike të UT-së, (<i>Statuti, Plani Strategjik, Rregulloren e Njesisë Kryesore dhe Programit të studimit</i>) dhe nga vizita në institucion, konkludon se: Organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në fushën e kontabilitetit dhe auditimit është bazuar në këto dokumenta strategjike që orientojnë misionin, qëllimin, objektivat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Ky program studimi synon kualifikimin shkencor të studentëve, përmes integritetit të procesit të mësimdhënies me kërkimin shkencor. Programi i studimit mbështetet dhe është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe zbaton të gjitha kërkuesat e akteve rregullatore të institucionit. <i>Dok. (Statuti i UT-së; Strategjia e zhvillimit të UT-së 2018-2023; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit).</i>
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	GVJ referuar shqyrtimit të Rregullores së Programit të Studimit, konstaton se emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e dokumentacionit të këtij programi studimi, është në zbatim të kriterëve të përcaktuara nga VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Përmbajtja e programit të studimit në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike që ka institucioni. Në këtë program studimi janë përcaktuar objektivat formuese të tij në përputhje me fushat përkatëse të kontabilitetit dhe auditimit. <i>Dok. (Statuti i UT-së; Rregullore UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit).</i>
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	Zhvillimet social-ekonomike në vendin tonë gjatë viteve të fundit, diktojnë nevojën e përgatitjeve të specialistëve nga ana profesionale të aftë për tregun e punës në nivel kombëtar, rajonal apo ndërkombëtar. GVJ, duke analizuar dokumentat strategjike, (<i>Statuti i UT-së, Strategjia e zhvillimit të UT-së 2018-2023, Rregulloren e Programit të Studimit</i>) dhe nga vizita në institucion, konkludon se: Programi i studimit është në përputhje me nevojat e shoqërisë për profesionin e kontabilistit dhe audituesit si dhe perspektivat e zhvillimit të vendit tonë. Ky program studimi mbështetet në strategjinë kombëtare të zhvillimit për integrim dhe në praktikën më të mira ndërkombëtare në lidhje me edukimin montabël bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Edukimit Kontabël.

	<i>Dok. (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015-2020, Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026; Rregullore e Programit të Studimit; Standardet Ndërkombëtare të Edukimit Kontabël).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i Rregullores së Programit të Studimit, konstaton se; objektivi kryesor i programit të studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”, është përgatitja e specialistëve dhe ekspertëve të mirfilltë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Programi i lëndëve dhe plani mësimor ofrojnë njohuri të thelluara dhe të specializuara teorike si dhe aftësi të pavaruara për kërkimin shkencor. Në përfundim të studimeve, programi synon që studenti të përfitojë njohuri dhe aftësi të thelluara teorike shkencore për një karrierë të suksesshme profesionale dhe akademike nga njëra anë dhe nga ana tjetër aftësi praktike për përshtatjen e tyre në tregun e punës.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT-së; Rregullore e Programit të Studimit; Dosja e Programit të Studimit MSh_KA; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar (<i>Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT-së; Rregullore e Programit të Studimit</i>) GVJ konstatoi se; Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” është hartuar duke pasur në konsideratë nevojat aktuale por dhe ato perspektive të zhvillimit ekonomik të vendit. Si rezultat i bashkëpunimit të universitetit, fakultetit dhe departamentit me një sërë institucionesh dhe organizata të profesionit të kontabilistit dhe audituesit (KKK, IEKA, IKM, KLSH, etj.), është bërë e mundur që të njihen dhe merren në konsideratë kërkesat dhe nevojat aktuale të tregut të punës gjatë hartimit të këtij program</p>

<p>mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>studimi. Në vitin 2018, nga universiteti është realizuar një studim, mbi problematikat e tregut të punës për studentët që diplomohen në UT. Gjithashtu nga departamenti është kryer një pyetësor në vitin 2022, me qëllim gjurmimin e ecuresë së studentëve të diplomuar në tregun e punës, përfshirë dhe këtë program studimi.</p> <p><i>GVJ rekomandon se nevojitet një studim më i mirfilltë dhe i thelluar mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës në Shqipëri lidhur me punësimin e studentëve, për tu realizuar në të ardhmen nga ana e Fakultetit dhe Departamentit.</i></p> <p><i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT-së; Rregullore e Programit të Studimit; Marrëveshjet e bashkëpunimit; Studimi i tregut të punës UT, 2018, Pyetësor, Lidhur me punësimin e studenteve, pas perfundimit të studimeve Master, 2022).</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar, Rregullores së programit të studimit, planit mësimor si dhe dokumentacionit shoqërues për këtë program studimi GVJ konkludon se; objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezulton se i përgjigjen nevojave të tregut të punës. Ky program realizohet me 120 kredite, dhe kohëzgjatja 2 (dy) vite akademike, që i përgjigjet nevojave të tregut të punës në sektorin privat dhe publik me njohuri të avancuara teorike-shkencore dhe aftësi praktike. Pas përfundimit të studimeve, studenti është i pajisur me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme, për tu punësuar si kontabilist, auditues, analistë i pasqyrave financiare, etj.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e programit të studimit; Kurrikula dhe Plani Mësimor; Studimi i tregut të punës, 2018, Pyetësor, Lidhur me punësimin e studenteve, pas perfundimit të studimeve Master, 2022).</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Ky program studimi, që me krijimin e tij në vitin 2010 por edhe në vijimësi është rishikuar dhe përmirësuar duke pasur në reference, programe të ngjashme të universiteteve evropiane dhe të sistemit anglosakson, për të pasqyruar praktikatat më të mira në këtë fushë edukimi, gjë që është reflektuar në përmbajtjen e programit dhe në syllabus-et e lëndëve. Programi i studimit është i ngjashëm me programet e studimit në universitete analoge evropiane dhe në këtë mënyrë ai lehtëson mobilitetin e studentëve apo punësimin e tyre në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. Gjatë takimit të GVJ me P/Dep, si dhe GVB u konfirmua se Departamenti i Kontabilitetit është përfshirë në një projekt të Bankës</p>

	<p>Botërore, ku është bërë rishikimi cilësor i kurrikulës dhe planit mësimor të këtij program studimi.</p> <p><i>Dok. (Projekti, Improvements to University Syllabuses; Implelented by AARC, 2017).</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së programit të studimit, kurrikulës dhe planit mësimor GVJ konkludon se; programi i studimit MSh_KA, është hartuar mbi bazën e kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë si dhe aktet nënligjore përkatëse, nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ky program studimi, është hartuar në përputhje me objektivat e FEUT, me direktivat e BE-së për arsimin e lartë si dhe praktikatat më të mira bashkëkohore europiane. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, konstatohet se syllabus-et janë përditësuar sipas modelit që është pjesë e VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi ka të pasqyruar përmbajtjen e detajuar dhe është vlerësuar me kredite sipas sistemit ECTS.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit te Studimit, Kurrikula dhe Plani Mësimor; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit, (Rregullores së UT/FEUT-së, Rregullores së Programit të Studimit, Kurrikulës dhe Planit mësimor) GVJ konstatoi se; janë përcaktuar në mënyrë të detajuar organizimi dhe vlerësimi i praktikave profesionale në këtë program studimi. Praktika profesionale është pjesë përbërëse e planit mësimor e kategorizuar si lëndë e formimit plotësues me 12 kredite. Praktika nga studentët kryhet pranë studiove të kontabilitetit, firmave të auditimit, subjekteve të ndryshme private, administratës publike, etj me të cilat institucioni ka marreveshje bashkëpunimi. Departamenti i Kontabilitetit për të siguruar mbarëvajtjen dhe respektimin e detyrimeve të studentit, ngarkon nje pedagog si mbikqyrës të praktikës i cili është edhe pedagogu udhëheqës i mikrotezës. Në përfundim të kryerjes së praktikës, studenti përgatit një raport që shoqërohet me formularin e vlerësimit të pedagogut udhëheqës. Vlerësimi përfundimtar bëhet me notë nga komisioni i mbrojtjes së praktikës i ngritur me urdhër të përgjegjësit të departamentit.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit;</i></p>

	<i>Dokumentacioni për praktikat mësimore dhe Korrespondenca me studentët).</i>			
Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	Nga takimi me P/Departamentit, GVB u konfirmua se ky program studimi, zhvillohet në gjuhën shqipe përveçse lektorët e huaj të ftuar dhe studentët e ardhur në kuadër të programeve Erasmus +. Në syllabuset e lëndëve të programit të studimit përfshihet, literatura në gjuhën angleze. Përfshirja e studentëve të huaj lidhet me programin Erasmus +, ku studentë nga Universiteti i Torinos, Itali kanë përzgjedhur të zhvillojnë lëndë në gjuhën angleze nga ky program studimi. Referuar dokumentacionit mbi mobilitetet e studentëve rezultoi se gjatë viteve akademike 2019-2020; 2020-2021 dhe 2021-2022, u është mundësuar 84 studentëve të FEUT, të zhvillojnë mësim një semestër në universitete të huaja, gjithashtu ka pasur dhe studentë të huaj që kanë zgjedhur të zhvillojnë mësim një semestër në FEUT. <i>Dok. (Syllabuset e lëndëve, Dokumentacioni për mobilitetet e studentëve&stafi akademik Erasmus +, 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022).</i>			
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Nga kontakti me P/Departamentit, GVB dhe përfaqësuesit e zyrave përkatëse, u konfirmua se në institucion ruhen dhe arkivohen në gjuhën angleze një pjesë e dokumentacionit lidhur me këtë program studimi, si, syllabuset, suplementi i diplomës, publikime të ndryshme, dokumentacioni për aktivitetet dhe konferencat e zhvilluara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike	Referuar shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të ngarkuar në faqen e ASCSL-it, u konstatua se UT ka një përvojë dhe një burime njerëzore në fushën akademike në përshtatje me qëllimin kryesor të këtij institucioni, përcjelljen

<p>për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>e dijes tek studentët. Mënyra e organizimit të UT dhe struktura hierarkike e tij janë në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të përcaktuara. FEUT dhe Departamenti i Kontabilitetit, që mbulon këtë program studimi, arrijnë të realizojnë me sukses objektivat e tij, nëpërmjet stafit akadaemik të kualifikuar dhe kapaciteteve infrastrukturore që kanë. Për këtë program studimi për vitin akademik 2022 janë të angazhuar 23 personel staf akademik efektiv (PAE), (nga të cilët 16 pedagoge të vetë departamentit, 6 pedagogë të Departamentit të Financës, dhe 1 pedagog të Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar) dhe 15 personel staf akademik me kontratë (PAK). Grupi i ekspertëve nga verifikimi i listës së stafit akademik për programin e studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” konstaton se mbi 60 % të nevojave plotësohen me staf akademik efektiv (Raporti midis personelit akademik efektiv dhe atij me kontratë është 23:15). Për të garantuar një shkallë të lartë përgjegjshmëore të krahasueshme me atë të stafit akademik efektiv në cilësinë e mesimdhënies, nga ana e departamentit është treguar kujdes i veçantë në angazhimin e personelit akademik me kontratë që ushtrojnë profesionin e kontablistit dhe audituesit ligjor. Nga pikëpamja e infrastrukturës, sallat dhe auditorët ku zhvillohen leksionet dhe seminarët janë të pajisura me projektore si dhe laboratorët me kompjuter dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e praktikave mësimore. <i>Dok. (Të dhëna tabelore për personelin akademik në njesinë kryesore dhe njesinë përgjegjëse/ bazë 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022; Lista e Personelit Akademik përgjegjës për programin e studimit_MSh_KA, CV e Personelit Akademik, Raporti vjetor për veprimtarite e kryera për personelin akademik).</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së UT/FEUT-së, Rregullores së Programit të Studimit, GVJ konstatoi se; fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njesisë kryesore dhe njesisë bazë që është përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi. Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” ofrohet nga Departamenti i Kontabilitetit, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e</p>

<p>direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga instucionet e arsimit të lartë”,i ndryshuar si dhe në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 i ndryshuar dt. 22.09.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë. <i>Dok. (Rregullore e UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FE; Rregullore e Programit te Studimit; CV e Personelit Akademik).</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi se; Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” funksionon në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e UT, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Në Statutin e UT, neni 11 përcaktohen njësitë kryesore dhe bazë të UT, ku Departamenti i Kontabilitetit është një nga njësitë bazë të Fakultetit të Ekonomisë. Në Rregulloren e UT, të miratuar me vendimin Nr. 5, datë 12.04.2010 të Senatit Akademik dhe të përmësirësuar disa herë, përmes disa vendimeve, në Nenin 12, paraqitet Departamenti i Kontabilitetit si një nga njësitë bazë të Fakultetit të Ekonomisë. <i>(Statuti i UT-së Rregullore e UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FE; Rregullore e Programit te Studimit).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përputhje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit,</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit te studimit dhe për të pëmbushur qëllimin e këtij programi studimi, njësia bazë dhe ajo kryesore,</p>

<p>siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>koordinojnë punën për të angazhuar staf akademik të kualifikuar. Strategjia dhe drejtimi i veprimtarisë së fakultetit bazohen në bashkëpunimin midis departamenteve. Njësia bazë për procesin mësimor dhe shkencor për realizimin e këtij programi studimi është Departamenti i Kontabilitetit. Në planin mësimor ka module që realizohen stafi akademik i departamenteve të tjera të FEUT, si Dep. i Financës, Dep. i Menaxhimit dhe Dep. i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar. Mbarëvajtja dhe mbikëqyrja e programit të studimit bëhet në formë të koordinuar nga të gjitha instancat drejtuese të FEUT-së. Një sërë zyrash janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor, si: Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Kurrikulave, Sekretaria Mësimore, etj. Përgjegjësi i Departamentit së bashku me përgjegjësit e grupeve lëndëve përgjigjen për vlerësimin e performancës së stafit akademik gjatë vitit akademik. <i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit; Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera për personelin akademik 2018-2021; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021).</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues (<i>lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>), GVJ konstatoi se për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe kryerjen e praktikave profesionale të studentëve, UT dhe FEUT, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata profesionale ku palët angazhohen për shkëmbim eksperiencë dhe ekspertizë në funksion të përmirësimit të procesit mësimor dhe realizimit të objektivave të programeve të studimit. Një bashkëpunim të gjerë FEUT ka edhe me një sërë aktorësh biznesi, për tu dhënë mundësi studentëve të kryejnë praktika profesionale në këto biznese. <i>Dok. (Lista e marreveshjeve të bashkepunimit; Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera për personelin akademik 2018-2021).</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,</p>	<p>Nga takimi me P/Departamentit, GVB dhe stafin akademik u konfirmua se, Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” është hartuar duke pasur në konsideratë nevojat aktuale por dhe ato perspektive të zhvillimit ekonomik të vendit. Departamenti i Kontabilitetit për realizimin e këtij programi studimi mbështetet në një bashkëpunim të gjerë me një sërë institucionesh dhe organizata profesionale të kontabilistit dhe auditimit (KKK, IEKA, IKM, KLSH, etj.). Gjithashtu FEUT ka edhe me një sërë marrëveshje bashkëpunimi</p>

<p>praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>me aktorë të ndryshëm biznesi. Këto institucione, organizata dhe aktorë biznesi mundësojnë për studëentët e këtij programi studimi, kryerjen e praktikës profesionale. Panairi i karrierës që zhvillohet në FEUT, është një aktivitet që rrit bashkëpunimin e fakultetit me aktorët e biznesit si dhe ofrohen mundësitë për zgjerimin e bizneseve partnere dhe punesimin e studenteve. <i>Dok. (Lista e marreveshjeve të bashkëpunimit; Raport për veprimtarinë e Zyrës Karrieres; Gjurmimi i studenteve).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues (<i>lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, dok. për praktikat mësimore etj</i>), GVJ konstatoi se FEUT i kushton një vëmendje të veçantë bashkëpunimit me institucione publike dhe private për të rritur dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe kryerjen e praktikës profesionale nga studentët. Për realizimin e praktikës fakulteti bashkëpunon me institucione publike qendrore dhe lokale si, Kuvendi Shqipërisë, Kryeministria, Minsitria e Financave, Bashkia Tiranë, bashkitë e rretheve si dhe biznese private Balfin Group, Megatek, Deloitte Albania, Ernst&Young Albania; NOA, Banka Kombëtare, PWC Albania etj. Departamenti i Kontabilitetit për të siguruar mbarëvajtjen dhe respektimin e detyrimeve të studentit, ngarkon pedagog mbikqyrës të praktikës i cili është edhe pedagogu udhëheqës i mikrotezës. Në përfundim të kryerjes së praktikës, studenti përgatit një raport që shoqërohet me formularin e vlerësimit të pedagogut udhëheqës. <i>Dok. (Lista e marreveshjeve të bashkëpunimit; Dokumentacioni për praktikat mësimore dhe Korrespondenca me studentët).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se; UT ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit si dhe institucione publike dhe jopublike në vend. Si rezultat i këtyre marreveshjeve me universitete të huaja (rreth 35), janë realizuar mobilitete për stafin akademik dhe studentët në kuadër të programeve Erasmus +. Referuar dokumentacionit mbi mobilitetet e studentëve rezulton se gjatë viteve akademike 2019-2020; 2020-2021 dhe 2021-2022, u është mundësuar 84 studentëve të FEUT, të zhvillojnë mësim një semestër në universitete të huaja, gjithashtu ka pasur dhe studentë të huaj që kanë zgjedhur të zhvillojnë mësim një semestër në FEUT. Gjithashtu gjatë vitit akademik 2021-2022 ka pasur 60 mobilitete nga stafi akademik, në kuadër të programeve Erasmus +.</p>


	<i>Dok. (Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Dokumentacioni për mobilitetet e studentëve&stafi akademik Erasmus +, 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022).</i>			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Nga takimi me P/Departamentit, GVB dhe stafin akademik si dhe verifikimi i dokumentacionit shoqëruar u konstatua se, Departamenti në mënyrë periodike në fund të vitit, bën analizën e punës mësimore dhe kërkimore shkencore, ku përfshihen edhe rezultatet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e ndryshme publike dhe private për këtë program studimi. <i>Dok. (Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera për personelin akademik 2018-2021; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	GVJ, duke analizuar dokumentat strategjike të UT-së, (<i>Statuti, Plani Strategjik, etj.</i>) konstatoi se, një nga misionet e UT-së është të inkurajojë dhe mbështesë stafin akademik dhe studentët përmes botimit të librave, artikujve shkencorë, pjesëmarrjes në konferenca shkencore, etj. FEUT, në vazhdimësi organizon konferenca shkencore, veprimtari të tjera si ëorkshope, me pjesëmarrjen e stafik akademik dhe studentëve, të cilat janë pasqyruar në faqen zyrtare të fakultetit. Departamenti i Kontabilitetit, ka organizuar workshopin me temë: “Fiskalizimi, mundësitë, sfidat dhe vështirësitë”, me pjesëmarrjen e një sërë aktorësh të interesit. Gjithashtu Dep. i Financës dhe Dep. i Kontabilitetit në bashkëpunim me Dep. e Menaxhimit të Universitetit të Torinos kanë organizuar konferencën shkencore ndërkombëtare “Financa dhe Kontabiliteti drejt Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm”. Pedagogët e Departamentit të Kontabilitetit që mbulon programin e studimit janë të angazhuar

	<p>gjithashtu në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, publikime në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Rezultatet e punimeve të kërkimit shkencor shpesh diskutohen në mbledhje Departamenti etj. Ndërsa për studentët kjo realizohet kryesisht në disa lëndë ku ata angazhohen në projekte të ndryshme kërkimore të cilat më pas mund ti prezantojnë në kuadrin e detyrave të kursit dhe përgatitjes të temës së diplomës.</p> <p><i>Dok. (Plani strategjik i UT, 2018-2023; Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera për personelin akademik 2018-2021; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues si dhe takimin e realizuara në institucion GVJ rezulton se; FEUT ka pjesë të organikës Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marredhënieve me Jashtë. Kjo drejtori në bashkëpunim me njësitë bazë mbi aktivitetet e punës kërkimore dhe shkencore bën të mundur zbatimin e planit strategjik për kërkimin shkencor. Në FEUT, zv/dekani për kërkimin shkencor, mbulon dhe ndjek veprimtarinë e kërkimit shkencor të njësive bazë në fakultet. Çdo vit akademik, pranë dekanatit, bëhet raportimi nga njësitë bazë për veprimtarinë kërkimore dhe shkencore të stafit akademik.</p> <p><i>Dok. (Plani strategjik shkencor i UT, 2018-2022; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me dekanin e fakultetit, P/Departamentit, GVB dhe stafin akademik u konfirmua se njësia kryesore, mbështet dhe promovon kërkimin shkencor, përmes menaxhimit të programeve administrative dhe financiare, infrasktrukturën shkencore, duke ofruar shërbime dhe akses për stafin akademik dhe studentët. Departamenti i Kontabilitetit si njësi bazë, ka organizuar konferenca, workshope dhe pjesëmarrje në projekte kërkimore.</p> <p><i>Dok. (Statuti i UT-së, Plani strategjik shkencor i UT, 2018-2022; Raporti vjetor per veprimtarite e kryera për personelin akademik; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021).</i></p>



<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues (<i>lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>), u konstatua se Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2016-2020, është një dokument për forcimin e sistemit të pronësisë intelektuale. Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërinstytucionale udhëhiqet nga parimi i mbrojtjes së pronësisë intelektuale</p> <p><i>Dok. (Marrëveshja e FEUT me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim/AADF).</i></p>
---	--

<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>GVJ, duke analizuar dokumentat strategjike të UT-së, (<i>Statuti, Plani Strategjik i Kërkimit Shkencor të UT-së</i>), konstatoi se institucioni, ka objektiv rritjen e mundësive dhe promovimin e perfshirjes së studentëve si dhe stafit akademik në studime, projekte shkencore dhe konsulenca për të tretët. FEUT-ja dhe Departamenti inkurajon studentët që të angazhohen në projekte të ndryshme kërkimore të cilat më pas mund t'i prezantojnë rezultatet e tyre në kuadrin e detyrave të kursit dhe përgatitjes së mikrotezave. Stafi akademik i departamentit, orienton dhe udhëheq studentët në përgatitjen e mikrotezave të diplomës. Gjithashtu një tjetër mundësi për kërkimin shkencor është organizimi i konferencave shkencore të përbashkëta, pjesëmarrja në projekte kërkimore, e stafit akademik në bashkëpunim me studentët.</p> <p><i>Dok. (Statuti i UT-së; Plani strategjik i kërkimit shkencor i UT, 2018-2022; Konferenca shkencore të FEUT; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021).</i></p>
---	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Standardi II.1

Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues (<i>Rregullore e programit të studimit, plani mësimor, etj.</i>) GVJ konstatoi se; Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” është hapur me Urdhër nr. 501, datë 08.11.2010 të MASH. Ky program studimi, është organizuar në module të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me kriteret e VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga instucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021. Ky program ka një kohëzgjatje prej 2 (dy) vite akademike me një total prej 120 kredite ku lëndët/modultet vlerësohen sipas Sistemit Evropian të Trasferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kreditet janë caktuar për çdo lëndë bazuar në ngarkesën mësimore në auditor si dhe në punën individuale të studentit, për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në syllabuset e lëndëve. Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” zgjat dy vite akademike, i organizuar në 4 semestra, në total 120 kredite/ECTS. Departamenti ka hartuar dhe miratuar Rregulloren e këtij programi studimi Master dhe ka përgatitur dosjen e plotë të këtij programi. Bazuar në planin mësimor dhe kurrikulën e programit të studimit ky program përfshin 15 module me një total prej 90 kredite, praktika profesionale 12 kredite dhe mikroteza ka 18 kredite.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit MSh_KA; Kurrikula dhe Plani Mësimor; Përshkrimi i programit të studimit; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të Rregullores së Programit të Studimit, GVJ konstatoi se; Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” ka si objektiv kryesor formimin e specialistëve dhe ekspertëve në fushëmn e kontabilitetit dhe auditimit. Struktura dhe plani mësimor i këtij program studimi, synojnë të përcjellin tek studentët njohuri teorike dhe praktike të kërkuara nga tregu i punës me qëllim aftësiminm e tyre në profesionin përkatës. Kjo realizohet përmes njohurive të marra</p>




	<p>gjatë zhvillimit të leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, projekteve kërkimore si dhe praktikave mësimore, duke harmonizuar njohuritë teorike me ato praktike për të inkurajuar dhe formuar tek studentët mendimin krijues dhe kritik si specialist të ardhshëm për tregun e punës në sektorin publik dhe atë privat.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Plani Mësimor; Syllabusët e lëndëve, Studimi i tregut të punës, 2018; Pyetësor, Lidhur me punësimin e studenteve, pas përfundimit të studimeve Master, 2022).</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e dosjes së këtij programi studimi dhe vizitën e realizuar në institucion, konstatohet se ky program studimi ofron një sistem të gjerë njohurish të thelluara në fushat kryesore, si kontabiliteti financiar i avancuar, standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, auditimit, analizën e pasqyrave financiare. Kjo realizohet përmes harmonizimit të njohurive teorike me ato praktike për të zhvilluar tek studentët mendimin krijues dhe kritik, ndër kërkesat bazë të profesionit kontabël dhe auditimit.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Plani Mësimor; Syllabusët e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Referuar, rregullores së programit të studimit, GVJ konstatoi se; Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” është i organizuar dhe strukturuar me qëllim thellimin e njohurive të studentët kanë marrë pas përfundimit të studimeve në ciklin e parë Bachelor. Përmes konsolidimit dhe përvetësimit të njohurive më të avancuara në fusha specifike të kontabilitetit dhe auditimit studentët kanë mundësi të kuptojnë dhe zgjidhin problemet më komplekse dhe praktike që mund të përballen gjatë eksperiencës të punës në të ardhmen. Hartimi i syllabuseve të lëndëve është bazuar jo vetëm në kërkesat që lidhen me kuadrin rregullor të IAL-ve, por edhe me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit Kontabël, si garanci drejt një karriere të suksesshme akademike apo profesionale.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Plani Mësimor; Syllabusët e lëndëve; Standardet Ndërkombëtare të Edukimit Kontabël).</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë</p>	<p>Grupi i ekspertëve të jashtëm pasi shqyrtoi, rregulloren e programit të studimit, planin mësimor, si dhe syllabusët e lëndëve, konstaton se struktura e programit dhe elementët përbërës të programit të studimit, gjejnë zbatim në të gjitha</p>

<p>strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015; VKM Nr.41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, si dhe dhe në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 i ndryshuar dt. 22.09.2020. Ky program studimi zhvillohet me kohë normale 2 vite akademike i ndarë në katër semestra, në total 120 kredite/ECTS. Programi është në përputhje me Nivelin 7 të Kornizës së Kualifikimeve Kombëtare. Referuar programit dhe planit mësimor, ky program studimi realizohet përmes ofrimit të 15 moduleve/lëndëve me një total prej 90 kredite, praktika profesionale 12 kredite dhe Mikroteza/Tema e diplomës ka 18 kredite. Struktura e këtij programi studimi ofruar nga Departamenti i Kontabilitetit në përputhje me kuadrin ligjor, përbëhet nga elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kreditet për secilën lëndë sipas sistemit europian ECTS, ▪ Syllabuset e lëndëve, që përfshijnë (format dhe metodat e mesimdhënies, kuadrin e përgjithshëm formues të programit të lëndës, objektivat formues për secilën lëndë, kontrollin e dijeve dhe mënyrën e vlerësimit), ▪ Plani mësimor, i detajuar sipas rubrkiave përkatëse, ▪ Kriteret specifike të pranimit të studentëve ▪ Diplomën dhe suplementin e diplomës. <p>Në fillim të çdo viti akademik, departamenti harton planin mësimor të mbështetur në kurrikulën përkatëse, dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm i cili miratohet nga dekanin e fakultetit.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Plani Mesimor; Syllabuset e lëndëve; Forma e diplomës dhe Suplementi i Diplomës).</i></p>
--	---



<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Referuar analizës së kurikulës dhe planit mësimor GVJ konstaton se, ky program studimi përfshin module/lëndë të ndara sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga instucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lëndët bazë të kategorisë A – 1 lëndë, 7 kredite, 2. Lëndët karakterizuese të kategorisë B – 11 lëndë, 67 kredite, 3. Lëndët ndërdisiplinore/integruese të kategorisë C – 3 lëndë, 16 kredite, 4. Lëndët plotësuese të kategorisë D – 1 lëndë, 12 kredite (praktika profesionale), 5. Detyrimet përmblyesëse të kategorisë E – 1 lëndë, 18 kredite (mikroteza). <p><i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit MSh_KA; Përshkrimi i Programit të Studimit; Plani Mësimor; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Referuar analizës së dosjes së programit të studimit GVJ konstaton se, programi i studimit përfshin realizimin dhe përgatitjen e mikrotezës. Referuar analizës së kurikulës dhe planit mësimor, mikroteza ka 18 kredite/450 orë, me të cilën studenti përmbyll detyrimet duke marrë diplomën Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”. Ky universitet bashkëpunon me një sërë institucionesh publike, organizata profesionale dhe biznese, duke ofruar mundësi reale kërkimore për studentët në përgatitjen e punimit të temës së diplomës në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Punimi i mikrotezës bëhet nën drejtimin e një pedagogu udhëheqës duke respektuar udhëzuesin përkatës për përgatitjen e mikrotezës. Për realizimin e temës së diplomës, studenti punon në mënyrë të pavarur. Megjithatë, nga diskutimi i realizuar me studentët dhe pedagogët e këtij programi rezultoi se studentët janë në komunikim të vazhdueshëm, duke përdorur si formën elektronike dhe komunikimin ballë për ballë me pedagogun udhëheqës për finalizimin e këtij procesi. Studentët pohuan se aktiviteti i tyre kërkimor është plotësisht i mbështetur nga ndihma e pedagogut udhëheqës. Ata gjithashtu pohuan pjesëmarrjen në konferencat të ndryshme studentore, në të cilat pasqyrojnë punën e tyre kërkimore që lidhet dhe me përgatitjen e mikrotezes. Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin e diplomës, sipas modelit të miratuar nga IAL sipas udhëzimeve të MAS.</p>



	<i>Dok. (Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Përshkrimi i Programit të Studimit; Plani Mësimor; Udhezues për përgatitjen e mikrotezës_MSh_FEUT; Dokumentacioni për praktikat profesionale dhe mikrotezës, Korrespondenca me studentët; Forma e diplomës dhe Suplementi i Diplomës).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Nga verifikimi i dokumentacionit (<i>Vendimit të BA, Urdhërit të MASH</i>), UT-ja është akredituar me Vendim BA Nr. 84, datë 27.10.2018, me kohëzgjatjen 4 vite, nga data 27.10.2018 deri në 26.10.2022. Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimeve Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”, është Fakulteti i Ekonomisë (FEUT). Njësia bazë përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi është Departamenti i Kontabilitetit. Këto njësi funksionojnë në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015 si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Statutin, Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit, etj. Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” është hapur me Urdhër nr. 501, datë 08.11.2010 të MASH. Ky program studimi i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit. <i>Dok (Vendimi i BA_ASCAL, Urdhër i MASH_Për hapjen e programit MSh_KA; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT, Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Lista e Personelit akademik të FEUT dhe Lista e Personelit akademik përgjegjes për programin e studimit_MSh_KA).</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit për këtë program studimi (<i>Rregullores së UT/FEUT, Te dhënave për personelin akademik, etj.</i>), Njësia kryesore për programin e studimeve Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”, është Fakulteti i Ekonomisë (FEUT). Ky fakultet ofron programe

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike

studimi në ciklin e parë të studimeve, Bachelor, ciklin e dytë të studimeve Master dhe në ciklin e tretë Doktoraturë. FEUT në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të tij si IAL publike, është i organizuar me një strukturë të tillë që siguron përmbushjen dhe objektivat e këtij programi studimi. Kjo njësi kryesore, në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi, ka në përbërjen e tij gjashtë njësi bazë (departamente):

1. Departamenti i Ekonomiksit;
2. Departamenti i Financës;
3. Departamenti i Kontabilitetit;
4. Departamenti i Marketing-Turizmit;
5. Departamenti i Menaxhimit;
6. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar;

Departamenti i Kontabilitetit është njësi bazë përgjegjëse e punës mësimore, kërkimore dhe shkencore për realizimin e këtij programi studimi. Departamenti është i organizuar në 3 gruplëndësh kryesore.

Departamenti i Kontabilitetit si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	2	3	2	3	2
Prof. Asoc.	5	1	4	-	4	1
Dr./PhD.	12	4	9	5	8	3
MSc.	10	8	10	6	3	11
Totali	29	15	26	13	18	17


Për sa i përket kualifikimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të Departamentit të Kontabilitetit në tre vite akademike është:

Për vitin akademik 2019-2020, 35 gjithsej (18 PAE / 17 PAK), nga këta 60 % me grada/tituj shkencore;

Për vitin akademik 2020-2021, 39 gjithsej (26 PAE/ 13 PAK), nga këta 60 % me grada/tituj shkencore;

Për vitin akademik 2021-2022, 44 gjithsej (29 PAE / 15 PAK) nga këta 60 % me grada/tituj shkencore.

	<p>Nësia kryesore e këtij programi, Fakulteti i Ekonomisë (FEUT), bashkërendon procesin e mësimdhënies me kërkimin shkencor në fusha të përafërta dhe të ndërthurura njëra me tjetrën. Fakulteti i Ekonomisë (FEUT) ka në përbërjen e tij një stat të kualifikuar dhe me përvojë në procesin e mesimdhënies dhe në kërkimin shkencor. Ky fakultet ka si personel akademik efektiv (PAE) 172 anëtarë, prej të cilëve 124 janë më tituj dhe grada shkencore. Në fakultet janë të angazhuar si personel akademik me kontratë (PAK) 326 anëtarë, prej të cilëve 88 janë më tituj dhe grada shkencore. Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor” dhe Përgjegjësi i Departamentit titullin akademik “Profesor”.</p> <p>Në vitin 2021-2022, gjatë takimeve me Dekanin dhe P/Dep., personeli akademik me kualifikimin Master Shkencor, u konfirmua se kanë filluar studimet në ciklin e tretë të doktoraturës, konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si edhe në Urdhërin nr.156, datë 24.02.2022 të MAS për riorganizimin e programit të studimeve të ciklit të tretë në “Shkencat ekonomike” në UT.</p> <p>Për sa më sipër njësia bazë përgjegjëse për programin, e studimit i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e UT; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse/ bazë 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022; Dosja e Programit të Studimit; Lista e Personelit akademik të FEUT dhe Lista e Personelit akademik përgjegjes për programin e studimit_MSh_KA).</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues (<i>Të dhënave tabelore për personelin akademik</i>), konstatoi se; Departamenti i Kontabilitetit në përbërjen e tij ka dhe 1 anëtarë si personel ndihmës akademik, që ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies. Nga vizita e realizuar në ambjentet e FEUT-s rezultoi se në funksion të këtij program studimi është një laborator më kapacitet me 30 PC, videoprojektor, në të cilët janë të instaluar programet e kontabilitetit alpha web, SPSS, dhe programe të tjera për realizimin e praktikave mësimore. Personeli ndihmës akademik në FEUT, ndihmon në realizimin e praktikave</p>



	<p>mësimore si dhe kujdeset për mirëmbajtjen e mjediseve të laboratorëve dhe pajisjeve përkatëse në to.</p> <p><i>Dok. (Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse/ bazë 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022; Lista e Personelit akademik të FEUT dhe Lista e Personelit akademik të Dep. përgjegjës për programin e studimit_MSh_KA; Foto të mjediseve të FEUT; Tabela për kapacitetet e sallave, laboratorëve dhe pajisjeve; Dosja e praktikave mësimore).</i></p>			
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues si dhe në takimin e realizuar me GVB dhe P/Dep dhe u konfirmua se; Njësia kryesore dhe njësitë bazë bazuar në aktet ligjore dhe nëligjore, për realizimin sa më mirë të objektivave si dhe për mbarëvajtjen e procesit mësimor kanë përcaktuar një personel akademik në rolin e koordinatorit. Për programin e studimeve Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”, koordinatori është përgjegjës i departamentit i cili përfaqëson autoritetin drejtues të njësisë bazë. Ai bashkëpunon, koordinon dhe monitoron me strukturat e tjera përgjegjëse mbarëvajtjen e ecurisë së zhvillimit të mësimit, angazhohet në zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë semestrit; ndjek zhvillimin e mësimit në përputhje me objektivat e programit dhe syllabuset e lëndëve, etj.</p> <p><i>Dok. (Vendimi i Njësisë Kryesore/FEUT për emërimin e koordinatorit të programit të studimit; Rregullore e Njësise Kryesore/FEUT, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA).</i></p>			
<p>Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Në takimin e realizuar nga GVJ me P/Dep dhe stafin akademik u konfirmua se Përgjegjësi i departamentit, në cilësinë e koordinatorit të programit të studimit, raporton në mënyrë periodike për veprimtaritë e njësisë bazë, ku një vend të rëndësishëm i kushtohet performancës së stafit akademik për këtë program studimi si dhe analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të departamentit.</p> <p><i>Dok. (Vendimi i Njësisë Kryesore/FEUT për emërimin dhe detyrat e koordinatorit të programit të studimit; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.3

Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se; Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore dhe Departamenti i Kontabilitetit si njësi bazë që është përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi, disponojnë dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, ku përfshihen: Kurrikula e programit të studimit, Planet mësimore, Syllabuset e lëndëve si dhe kategorizimin e lëndëve sipas kriterëve ligjore në fuqi.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Përshkrimi i Programit të Studimit; Kurrikula dhe Planet mësimore; Syllabuset e Lëndëve).</i></p>												
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar analizës së dosjes së programit të studimit (rregullores, kurikulës dhe planit mësimor) GVJ konstaton se; Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” është i organizuar në 2 vite akademikë me 4 semestra. Referuar programit dhe planit mësimor, ky program studimi realizohet përmes ofrimit të 15 moduleve/lëndëve me një total prej 90 kredite, praktika profesionale 12 kredite dhe Mikroteza/Tema e diplomës ka 18 kredite (në total, 120 kredite).</p> <p>Program i studimi MSHKA përfshin module/lëndë të ndara sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga instucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, si vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Komponenti mësimor</th> <th>Kërkesat ligjore Master i shkencave</th> <th>MSHKA / Kredite</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>LËNDË BAZË – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (1 lëndë)</td> <td>5–10% (kredite)</td> <td>7 (kredite) 6%</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>LËNDË KARAKTERIZUESE – Përgatitje për disiplinën shkencore (11 lëndë)</td> <td>50–60% (kredite)</td> <td>67 (kredite) 56%</td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria	Komponenti mësimor	Kërkesat ligjore Master i shkencave	MSHKA / Kredite	A	LËNDË BAZË – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (1 lëndë)	5–10% (kredite)	7 (kredite) 6%	B	LËNDË KARAKTERIZUESE – Përgatitje për disiplinën shkencore (11 lëndë)	50–60% (kredite)	67 (kredite) 56%
Kategoria	Komponenti mësimor	Kërkesat ligjore Master i shkencave	MSHKA / Kredite										
A	LËNDË BAZË – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (1 lëndë)	5–10% (kredite)	7 (kredite) 6%										
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – Përgatitje për disiplinën shkencore (11 lëndë)	50–60% (kredite)	67 (kredite) 56%										

C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUE SE – Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (3 lëndë)	12–20% (kredite)	16 (kredite) 13%
D	LËNDË PLOTËSUESE – Gjuhë të huaja, njohuri informatike, (praktika profesionale)	10% (kredite)	12 (kredite) 10%
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE (Mikroteza)	10–15% (kredite)	18 (kredite) 15%

Dok. (Dosja e Programit të Studimit; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Përshkrimi i Programit të Studimit; Plani Mesimor; Syllabuset e lëndëve).

Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.

GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit (*dosjes së programit të studimit, rregullores, kurikulës dhe planit mesimor*) konstaton se; Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”, është i organizuar në 2 vite akademikë me 4 semestra. Lëndët janë vlerësuara me kredite/ECTS. Shpërndarja e lëndëve referuar planit mesimor sipas semestrave janë si në vijim:

Semestri	Lëndët
Semestri I (5 lëndë)	1. Tregjet dhe Institucionet Financiare (6 kredite) 2. E drejtë Biznesi (6 kredite) 3. Organizimi i Sistemeve të Kontrollit Kontabël (6 kredite) 4. Standardet Ndërkombëtare dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (6 kredite) 5. Metodologjia e Kërkimit dhe Metodatat Sasiore në Kontabilitet (6 kredite)
Semestri II (5 lëndë)	6. Kontabiliteti Drejtimi i Avancuar (7 kredite) 7. Kontabiliteti Financiar i Avancuar (7 kredite) 8. Kontabiliteti Publik dhe i OJF-ve (6 kredite) 9. Drejtimi Financiar i Avancuar (6 kredite) 10. Lëndë me zgjedhje (Kontabiliteti i Sigurimeve dhe i Bnkave/Kontabiliteti Ligjor, Qeverisje e Korporatave, Menaxhim Risku) (5 kredite)
Semestri III (5 lëndë)	11. Analiza e Pasqyrave Financiare (6 kredite) 12. Auditimi dhe SNA (6 kredite) 13. Legjislacioni dhe Administrimi tatimor dhe Tregtar i Biznesit (6 kredite)

	14. Shërbimet e Konsulencës, të Dhënies së Sigurisë e të tjera Profesionale (6 kredite)
	15. Lëndë me zgjedhje (Etika Profesionale, Financat Publike, Modelimi i Spreadsheet-ve në Kontabilitet) (5 kredite)
Semestri IV	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Praktika Profesionale (12 kredite) ▪ Mikroteza (18 kredite)
Totali	120 kredite/ECTS

Për vitin e parë referuar planit mësimor 2012-2022, studenti grumbullon 61 kredite dhe vitin e dytë 59 kredite, pra në total 120 kredite për dy vitet akademike.

Rekomandohet të rishikohet shpërndarja e lëndëve për vitin e parë dhe të dytë në raportin 60:60 kredite, sipas pikës 2, neni 70, Ligji nr. 80 2015, Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.


Dok. (Dosja e Programit të Studimit; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Përshkrimi i Programit të Studimit; Plani Mesimor; Syllabuset e lëndëve).

Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.

Nga verifikimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se; Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”, bazohet në Rregulloren e UT/Njesise Kryesore/FEUT si dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Programi dhe plani mësimor, pasqyron informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Programi dhe plani mësimor përbën dokumentacionin kryesor dhe përfshin elementët e mëposhtëm në përputhje me VKM nr.41 dt. 24/01/2018 e ndryshuar:

1. Emërtimin për secilin modul të këtij programi studimi, të grupuara dhe të renditura sipas semestrave përkatës;
2. Numrin e krediteve për çdo modul;
3. Orët në total për secilin modul dhe raporti i orëve (leksione/seminare);
4. Detyrimet për secilin modul (leksione; seminare, ushtrime, detyra kursi, projekte kursi, raste studimore, provime të ndërmjetëm, dhe provimi përfundimtar);
5. Raporti i vlerësimit të studentit (vlerësimi gjatë vitit dhe provimi përfundimtar);
6. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve për çdo lëndë.

	<p>studimeve në përputhje me statutin e UT-së dhe rregulloret përkatëse. Mundësia e transferimit të krediteve rrit fleksibilitetin e programit të studimit për studentët dhe u krijon hapësirë për studime të mëtejshme në IAL të tjera bredna dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Dok. (Statuti i UT-së; Rregullorja e UT-së; Rregullorja e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Kuotat e propozuara).</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Referuar dokumentacionit përkatës, (<i>Dosja e Programit të Studimit dhe Rregullorja e Programit të Studimit</i>) japin një informacion të plotë për të gjithë elementët formues të programit të studimit. Syllabuset e lëndëve janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas VKM-së Nr. 41 datë 24.01.2018 të përditësuar “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Syllabuset përmbajnë informacione të përgjithshme si: titulli i lëndës, titullari, ngarkesa në orë dhe kredite, tipologjia e lëndës (kategoria), viti dhe semestri kur zhvillohet lënda, lloji i lëndës, programi i studimit të cilit i përket, temat e lëndës, mënyrën e kontrollit të dijeve të lëndës. Studentët informohen nga pedagogët në lidhje me përmbajtjen e programit të lëndës, zhvillimin e leksioneve, seminarëve, ushtrimeve, esseve/detyrave të kursit dhe mënyrat e vlerësimit, etj.</p> <p><i>Dok. (Dosja e Programit të Studimit; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Përshkrimi i programit; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Përgjatë takimeve në institucion me stafin akademik që zhvillojnë mësim në këtë program studimi, GVJ u informua se çdo fillim viti ka pasur rishikime të vazhdueshme të lëndëve apo moduleve sipas gruplëndëve të cilat reflektojnë zhvillimet ekonomike kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe ato të shkencës dhe teknologjisë së informacionit. Nga takimi me stafin akademik të departamentit u informuam se në syllabuset rishikohen dhe shmangen tema të ngjashme apo të njëjta midis lëndëve. Gjithashtu rishikohet literatura dukë përditësuar dhe përfshirë në tekste apo cikël leksionesh të reja. Diskutimi përfundimtar për ndryshimet përkatëse, bëhet në mbledhjen e departamentit për të marrë miratimin përpara fillimit të vitit të ri akademik.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Raporti vjetor i analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit; Syllabuset e Lëndëve).</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit shoqërues, rezulton se ngarkesa e programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Kontabiliteti dhe Auditim” është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe rregulloret përkatëse. Ngarkesa mësimore javore në auditor sipas lëndëve përfshin leksione, seminare, ushtrime, detyra/projekte kursi, praktika mësimore, etj.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e UT; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Plani Mesimor; Syllabuset e Lëndëve; VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga instucionet e arsimit të lartë”; Ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019; Nr. 185, datë 25.3.2021).</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar dokumentacionit përkatës, Dosjes së Programit të Studimit si dhe Rregullores së Programit të Studimit rezulton se; Emërtimi dhe përmbajtja e lëndëve të këtij programi studimi, është në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, mundësojnë një thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme të studentëve. Lëndët referuar kurrikulës dhe planit mësimor synojnë formimin e studentit në fushën përkatëse. Objektivi kryesor i këtij program studimi, është përgatitja e specialistëve dhe ekspertëve të mirfilltë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Programi i lëndëve dhe plani mësimor ofrojnë njohuri të avancuara dhe të specializuara teorike si dhe aftësi të pavaruara për kërkimin shkencor. Në përfundim të studimeve, programi synon që studenti të përfitojë njohuri dhe aftësi të thelluara teorike nga njëra anë dhe nga ana tjetër aftësi praktike për përshtatjen e tyre në tregun e punës.</p>

	<p><i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Plani Mesimor; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit shoqërues, GVJ, konstaton se Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”, bazuar në Rregulloren e programit të studimit, është i organizuar në 2 vite akademikë me 120 kredite të shpërndara përkatësisht 61 kredite për vitin e parë dhe 59 kredite për vitin e dytë. Ngarkesa mësimore javore në auditor sipas lëndëve është 25 orë dhe studim i pavarur i studentit.</p> <p>Kurrikula e mësimit është e strukturuar në mënyrë të tillë; duke i ndarë lëndët në: lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe integruese të profilit (lëndë me zgjedhje), lëndë plotësuese(praktikës profesionale) si dhe detyrimeve përmbyllse (përgatitja e mikrotezës). Referuar shqyrtimit të kurikulës dhe planit mësimor, ky program studimi realizohet përmes ofrimit të 15 moduleve/lëndëve të cilat kanë nga 6-7 kredite, praktika profesionale 12 kredite dhe mikroteza 18 kredite. Përmbajtja dhe struktura e lëndëve të këtij programi studimi si dhe kryerja e praktikës profesionale për një periudhë 3 muaj u ofrojnë mundësi studentëve që të marrin njohuri të thelluara teorike si dhe aftësi praktike të pavarura për kërkimin shkencor.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Plani Mësimor; VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga instucionet e arsimit të lartë”, Ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019; Nr. 185, datë 25.3.2021).</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit grupi i ekspertëve, konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në “Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” është fokusuar kryesisht në dhënien e njohurive të nevojshme teorike dhe praktike për tregun e punës si dhe kërkimin shkencor. Drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë (Departamenti i Kontabilitetit), referuar bashkunitimit me një sërë institucionesh dhe organizma profesionale si KKK, IKM, SHFKSH, KLSH si dhe subjekte të ndryshme private, ku studentët kryejnë praktikat profesionale ka evidentuar kërkesat e tyre të vazhdueshme për specialistë në fushëm e kontabilitetit, auditimit, analistë të pasyrave financiare etj, të cilat reflektuar dhe strukturën e këtij program studimi për secilën lëndëve, sa i përket raportit në nivelin teorik dhe praktik. Në këtë program studimi, raporti</p>

	<p>ndërmjet formimit teorik dhe atij praktik për të gjitha lëndët është 2:2-3 (2 orë leksione në auditor dhe 2-3 seminare/ushtrime/praktikë mësimore në laboratorë. Programi i lëndëve të këtij programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që i krijon studentëve mundësi transferimi të studimeve, pasi përmbajtja është e krahasueshme me njohuritë që studenti mund të marrë në institucione të tjera brenda apo jashtë vendit.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Plani Mësimor; Lista e marreveshjeve të bashkëpunimit).</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të rregullores së programit të studimit dhe planit mësimor, rezulton se shpërndarja e ngarkesës mësimore sipas lëndëve është realizuar me synimin që studenti të ketë afëtsi për tu përshtatur sa më shpejt në tregun e punës në përputhje me njohuritë e marra gjatë periudhës së studimeve si dhe zhvillimn drejt një karriere të sukseshme në profesion apo për ndjekjen e studimeve në ciklin e trtë të doktoraturës.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Plani Mesimor).</i></p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në takimin e realizuar me Përgjegjësin e Departamentit dhe me stafin akademik që zhvillojnë mësim në këtë program studimi konfirmuan se syllabuset përditësohen në mënyrë periodike, duke përfshirë edhe mendimin apo opinionin si të lektorëve, por edhe të partnerëve (institucione dhe organizatat profesionale) që kanë marrëveshje bashkunimi. Pedagogët pohuan se çdo fillim viti, diskutohet dhe bëhet përditësimi apo rifreskimi i syllabuseve duke përfshirë në to botimet e fundit dhe literaturën në fushën përkatëse. Përmirësimet e realizuara në syllabuse miratohen nga Grupet e Lëndëve dhe Departamenti përpara fillimit të vitit të ri akademik. Në përgjithësi syllabuset e lëndëve të këtij program studimi, janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas VKM-së Nr. 41 datë 24.01.2018, e ndryshuar "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL". Të gjitha syllabuset arkivohen në departament në kopje dixhitale dhe në hardcopy.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Përshkrimi i programit; Plani Mesimor; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimn e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për</p>	<p>GVJ, referuar shqyrtimit të rregullores së programit të studimit konstaton se; Programi i studimit është ndërtuar bazuar mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe thëllon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në punën kërkimore shkencore dhe aplikative në përputhje me objektivat e këtij</p>



<p>programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>programi. Pas përfundimit të këtij programi studimi, studentët kanë përfituar njohuritë e dhe kompetencat e nevojshme, për tu punësuar si drejtues kontabiliteti në bizneset e mesme dhe të mëdha, si auditues i brendshëm ne sektorin publik dhe atë privat, si analist i pasqyrave financiare, etj. Gjithashtu studentët ka mundësi punësimi në institucione në nivel lokal dhe qendror, institucione kërkimore dhe shkencore si dhe në organizata të ndryshme profesionale në pozicionin e kontabilistit dhe audituesit ligjor.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Përshkrimi i programit; Syllabuset e lëndëve; Pyetësor, Lidhur me punesimin e studenteve, pas perfundimit të studimeve Master, 2022; Gjurmimi i Studenteve; Veprimtaria e Zyrës Karrieres).</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues (<i>Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, etj.</i>) FEUT ka marrëveshje bashkëpunimi me aktorë dhe partnerë të ndryshëm të sektorit publik dhe atij privat. Departamenti i Kontabilitetit për realizimin e këtij programi studimi mbështetet në një bashkëpunim të gjerë me një sërë institucionesh dhe organizata profesionale të kontabilistit dhe auditimit (KKK, IEKA, IKM, SHKFSH, KLSH, etj.). Panairi i karrierës që zhvillohet në FEUT, është një aktivitet që rrit bashkëpunimin e fakultetit me aktorët e biznesit duke rritur mundësitë për zgjerimin e bizneseve partnere dhe punesimin e studenteve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesave të tregut të punës. Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” u mundëson studentëve vijimin e mëtejshëm të karrierës akademike në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Përshkrimi i programit; Lista e Marrëveshjeve të bashkepunimit me IKM, KLSH, KKK, etj; Studimi i tregut të punës, 2018, Pyetësor, Lidhur me punesimin e studenteve, pas perfundimit të studimeve Master, 2022; Gjurmimi i Studenteve; Raport për veprimtarinë e Zyrës Karrieres).</i></p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e</p>	<p>GVJ nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se; FEUT ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi me aktorë dhe partnerë të ndryshëm të sektorit publik dhe atij privat. Gjithashtu Departamenti i Kontabilitetit për realizimin e këtij programi studimi mbështetet në një bashkëpunim të gjerë me një sërë institucionesh dhe organizata profesionale të kontabilistit dhe</p>

bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	auditimit (KKK, IEKA, IKM, KLSH, etj.). Në takimim e GVJ me P/Dep dhe grupin e vlerësimit të brendshëm u konfirmua se strukturat përkatëse dhe përgjegjëse, marrin në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve për të përmirësuar përmbajtjen dhe strukturën e programit të studimit me qëllimin rritjen e mundësive të punësimit të studentëve në tregun e punës. <i>Dok. (Përshkrimi i programit; Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me IKM, KLSH, KKK, etj, Organizimi i Panairit të Punës; Raport për veprimtarinë e Zyrës Karrieres).</i>			
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	GVJ, referuar shqyrtimit të rregullores së programit të studimit konstaton se; në përfundim të këtij programi studimi, studentët zotërojnë njohuri të avancuara dhe janë të aftë për tu përfshirë në studime, analiza dhe projekte kërkimore-shkencore. Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” u mundëson studentëve vijimin e mëtejshëm të karrierës akademike në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës. <i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit MSh_KA; Përshkrimi i programit; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	GVJ, referuar dokumentacionit përkatës, (<i>Dosjes së Programit të Studimit si dhe të dhënave për personelin akademik</i>) konstaton se; Departamenti i Kontabilitetit si njësi bazë për këtë program studimi, ka në përbërje personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohen në realizimin me sukses të

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

programit të studimit MSHKA. Personeli akademik që angazhohet në procesin e mësimdhënies në programin e studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” përmbush të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. Te dhënat për personelin akademik përgjegjës për programin e studimit paraqiten si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik për Programin e Studimit	2021-2022		2020-2021		2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	2	3	2	3	2
Prof. Asoc.	5	1	4	-	4	1
Dr./PhD.	8	4	4	5	5	3
MSc.	8	8	7	6	2	11
Totali	23	15	18	13	14	17

Për sa i përket kualifikimeve të Personelit Akademik:

- Për vitin akademik 2019-2020, 58% e stafit akademik (PAE&PAK) kanë gradë shkencore/tituj akademik, 42% janë me Msc;
- Për vit akademik 2020-2021, 58% e stafit akademik (PAE&PAK) kanë gradë shkencore/tituj akademik, 42% janë me Msc;
- Për vitin akademik 2021-2022, 58% e stafit akademik (PAE&PAK) kanë gradë shkencore/tituj akademik, 42% janë me Msc.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, raporti midis personelit akademik efektiv (PAE) dhe personelit akademik me kontratë (PAK) është në raportin **23/15 ose 60.5% me 39.5%**.

Ndërsa referuar të dhënave dhe dokumentacionit për ngarkesën mësimore për vitin akademik 2021-2022, rezulton se **70%** mbulohet nga personeli akademik efektiv (PAE) dhe **30 %** nga personeli akademik me kontratë (PAK).

Dok. (Dosja e Programit të Studimit; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; CV e Personelit Akademik; Syllabuset e lëndëve; Të dhëna tabelore për personelin akademik në njesinë kryesore dhe njesinë përgjegjëse/ bazë 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022; tabela 6.1, 6.2; 6.3; dhe tabela 11.1).

<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga takimi i realizuar nga GVJ me P/Dep. dhe stafin akademik u konfirmua se Departamenti i Kontabilitetit si njësi bazë, ka synuar të realizojë përputhjen e fushave akademike-kërkimore të përgjithshme dhe specifike të personelit akademik me objektivat e programit të studimit. Fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku japin mësim. Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik të këtij programi, kjo evidentohet nga kërkimi shkencor, për marrjen e gradës “Doktor”, publikimet e artikujve shkencorë dhe referimet në konferencat shkencore që përputhet me ekspertizën në fushat që ata kanë dhe me natyrën e moduleve që mbulojnë në këtë program studimi. Fushat kryesore kërkimore të personelit akademik janë raportimi financiar dhe auditimi, të cilat pasurohen dhe me fushat specifike kërkimore si ofrimi i shërbimeve të sigurisë dhe konsulencës, zbatimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, metodologjia e kërkimit, analiza e pasqyrave financiare, etika profesionale, auditimi i brendshëm, etj.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse/ bazë 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022; CV e Personelit Akademik; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se; FEUT ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit si dhe me një sërë institucionesh publike dhe jopublike në vend. Departamenti i Kontabilitetit për realizimin e këtij programi studimi mbështetet në një bashkëpunim të gjerë me një sërë institucionesh dhe organizata profesionale të kontabilistit dhe auditimit (KKK, IEKA, IKM, SHKFSH, KLSH, etj.). Departamenti ka krijuar një grup pune i përbërë nga stafi akademik dhe ndihmës akademik, i cili është përgjegjës për këshillimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve për praktikën profesionale dhe realizimin e mikrotezës. Grupi i punës ka krijuar postën elektronike për të komunikuar me studentët, për shpërndarjen e informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e praktikës profesionale dhe përgatitjen e mikrotezes apo dhe për pjesëmarrjen e studentëve në konferencat shkencore. Kjo postë ka shërbyer si mënyrë komunikimi në vazhdimësi midis studentit dhe pedagogut udhëheqës, i cili</p>

	mbikëqyr dhe udhëheq studentin në gjatë kryerjes së praktikës profesionale dhe përgatitjes së mikrotezës. <i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; CV e Personelit Akademik; Dosja e udhëheqjes së praktikave mësimore dhe mikrotezës; Korrespondenca me studentet për përgatitjen e mikrotezës).</i>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ, referuar dokumentacionit përkatës, (<i>Dosjes së Programit të Studimit si dhe të dhënave për personelin akademik dhe ndihmës akademik</i>) konstaton se Departamenti i Kontabilitetit ka në përbërjen e tij dhe 1 (një) anëtarë si personel ndihmës akademik, që ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies dhe koordinimin e aspekteve administrative. Personeli ndihmës akademik në FEUT, ndihmon në realizimin e praktikave mësimore si dhe kujdeset për mirëmbajtjen e mjediseve të laboratorëve dhe pajisjeve përkatëse. <i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Plani Mësimor; Të dhëna tabelore për personelin akademik në njesinë kryesore dhe njesinë përgjegjëse/ bazë 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga takimet e realizuara në institucion me strukturat përkatëse, GVJ konstaton se; FEUT ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi me aktorë dhe partnerë të ndryshëm të sektorit publik dhe atij privat. Departamenti i Kontabilitetit në hartimin dhe përgatitjen e programit studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” ka pasur në konsideratë nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për profesionistë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, si një nevojë e domosdoshme e zhvillimeve të ekonomisë dhe e reformave të ndërmarra nga qeveria në fushën e kontabilitetit dhe

	<p>auditimit. Departamenti bashkëpunon me një sërë institucionesh dhe organizata profesionale të kontabilitetit dhe auditimit (KKK, IEKA, IKM, SHKFSH, KLSH, etj.) Pjesëmarrja e stafit akademik në strukturat vendimmarrëse të këtyre institucioneve dhe organizatave, ka bërë të mundur që departamenti të marrë në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve për të përmirësuar përmbajtjen dhe modulet e këtij programi studimi me qëllimin rritjen e mundësive të punësimit të studentëve në tregun e punës.</p> <p><i>Dok. (Përshkrimi i programit; Lista e marreveshjeve të bashkëpunimit, Marreveshje bashkëpunimi me IKM, KLSH, Organizimi i Panairit të Punës; Veprimtaria e Zyrës Karrierës).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në takimin e realizuar nga GVJ me P/Dep., përfaqësues të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DCBCK) si dhe me studentët u konfirmua se; në realizimin e objektivave të tij, institucioni merr në konsideratë mendimet e studentëve përmes plotësimit të pyetsorëve. Bazuar në “Manualin e Cilësisë në UT”, studentët inkurajohen që të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor. Në vitin 2018, nga universiteti është realizuar një studim, mbi problematikat e tregut të punës për studentët që diplomohen në UT. Gjithashtu nga departamenti është kryer një pyetësor në vitin 2022, me qëllim gjurmimin e ecurisë së studentëve të diplomuar në tregun e punës, përfshirë dhe këtë program studimi. Studentët kanë përfaqësinë e tyre në Senatin akademik, Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, Zyrën e Sigurimit të Cilësisë, Zyra e Karrierës etj. Studentët gjithashtu organizohen në Këshilla studentore, ku shprehin mendimet dhe propozimet e tyre për problematika të ndryshme duke përfshirë këtu edhe çështje të procesit mësimor dhe programeve të studimeve. Nga takimi i realizuar me studentët mësuam se ata janë në dijeni të këtyre strukturave dhe të funksionimit të tyre.</p> <p><i>Dok. (Studimi i tregut të punës UT, 2018; Pyetësor, Lidhur me punesimin e studenteve, pas perfundimit të studimeve Master, 2022; Manuali i Cilësisë i UT-së; Veprimtaria e Zyrës Karrierës).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për</p>	<p>Gjatë takimeve të realizuar me GVB, P/Dep. dhe përfaqësues të Zyrës së Karrierës u konfirmua se; FEUT dhe njësia bazë mban kontakte dhe shkëmben mendime në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar. Nga analiza e pyetsorit të kryer nga</p>

<p>përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti, konstatohet se studentët janë të kënaqur në lidhje me përmbajtjen dhe objektivat e programit të studimit.</p> <p>Nga takimet e GVJ me ZKA rezulton se Bordi i Alumnit është ngritur si strukturë, por ende nuk ka realizuar aktivitete që të mbajë kontakte të vazhdueshme lidhur me gjurmimin e studentëve të diplomuar rreth punësimit dhe karrierës së tyre profesionale.</p> <p><i>GVJ rekomandon që, ZKA të mbajë kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, sa i përket gjurmimit dhe të dhënave rreth punësimit dhe karrierës së tyre profesionale.</i></p> <p><i>Dok. (Pyetësor, Lidhur me punësimin e studenteve, pas perfundimit të studimeve Master, 2022; Gjurmimi i Studentëve; Veprimtaria e Zyrës Karrierës).</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se; Fakulteti i Ekonomisë bashkëpunon me një sërë institucionesh kërkimore dhe shkencore, ku stafi akademik është i angazhuar në projekte kërkimore dhe shkencore. Departamenti i Kontabilitetit si njësi bazë bashkëpunon me një sërë institucionesh dhe organizata profesionale të kontabilitetit dhe auditimit (KKK, IEKA, IKM, SHKFSH, KLSH, etj.) duke marrë në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve për të përmirësuar përmbajtjen dhe modulet e këtij programi studimi.</p> <p>Gjithashtu nga takimet me GVB u konfirmua, pjesëmarrja e stafit akademik në projekte në nivel fakulteti dhe në nivel departamenti. (Projekti i fituar nga Departamenti i Kontabilitetit “Leading Towards Sustainable Gender Equality Plannts in Research Institutions LeTSGEPs”).</p> <p><i>Dok. (Lista e marreveshjeve të bashkëpunimit; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021; Format për raportin vjetor për veprimtaritë e kryera të FEUT).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi II.7

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------

<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit shoqërues (<i>Statuti i UT-së; Rregullorja e UT-së; Rregullorja e programit të studimit</i>), GVJ konstaton se; ndërtimi dhe organizimi i programeve të studimeve në UT, udhëhiqet nga nevoja dhe fleksibiliteti, për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave në tregun e punës. Objektivat e programit të studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” janë në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit. Departamenti i Kontabilitetit ka prioritet që të ofrojë një program studimi me në qendër studentin, për ti përgatitur më një karrierë produktive dhe profesionale dhe për të qenë të aftë dhe të pergjegjsshëm në ofrimin e shërbimeve profesionale me interes publik. <i>Dok. (Statuti i UT-së; Rregullore e UT-së; Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Përshkrimi i Programit të Studimit; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Në takimin e realizuar nga GVJ me stafin akademik të këtij programi studimi u konfirmua se departamenti mbështet, nxit dhe respekton stafin akademik në organizimin e veprimtarive të mësimdhënies, në punën e tyre kërkimore-shkencore, në pjesëmarrjen në studime dhe projekte të ndryshme në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas dhe të huaj si dhe në shkëmbimin e eksperiencave dhe kualifikimin e tyre. Departamenti si njësia bazë, nxit dhe mbështet, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore-shkencore, duke respektuar lirinë akademike të stafit akademik. <i>Dok. (Statuti i UT-së; Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit, GVJ konstaton se; programi i studimit ka si qëllim t'iu mundësojë dhe ofrojë studentëve pjesëmarrjen në projekte dhe aktivitete kërkimore dhe shkencore. Nga takimi i realizuar me pedagogët e këtij programi studimi dhe mësuam se studentët janë nxitur gjithmonë dhe janë përfshirë në aktivitete kërkime, studime dhe projekte të ndryshme. Gjithashtu ata kanë bashkëpunuar me pedagogët në realizimin e studimeve apo punimeve për tu paraqitur në konferenca shkencore. Studentët e këtij programi studimi me mbështetjen e pedagogëve të departamentit kanë marrë pjesë në konferenca shkencore të organizuara në nivel fakulteti.</p>

	<i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Lista e konferencave shkencore; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021).</i>
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	<p>Nga shyrtimi i dokumentave strategjike të UT-së, (<i>Statuti i UT-së, Plani Strategjik të Zhvillimit të UT-së</i>) GVJ konstaton se; Programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimet ekonomike në vendin tonë gjatë viteve të fundit, me qëllim përgatitjen e specialistëve të aftë për tregun e punës në nivel kombëtar, rajonal apo ndërkombëtar. Ky program studimi mbështetet në praktikën më të mira në lidhje me zhvillimet e profesionit kontabël, bazuar në Standardet Ndërkombëtare të edukimit Kontabël. Përcjellja tek studentët e dijeve dhe njohurive të avancuara teorike dhe praktike në fushën e kontabilitetit dhe të auditimit përbëjnë misionin dhe objektivat e këtij programi studimi.</p> <p><i>Dok. (Strategjia e zhvillimit të UT-së 2018-2023, Statuti i UT-së; Rregullore dhe Përshkrimi i Programit të Studimit_MSh_KA).</i></p>
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	<p>GVJ, duke analizuar dokumentat strategjike të UT-së, (<i>Statuti i UT-së, Plani Strategjik i Kërkimit Shkencor të UT-së</i>), konkludon se, institucioni angazhohet që të mbështesë aktivitetet kërkimore dhe studimore të njësi bazë, duke qenë se kërkimi dhe projektet kërkimore shkencore janë pjesë e objektivave që merren parasysh në hartimin e projekt buxhetit të institucionit.</p> <p>Në takimin e GVJ me dekanin e FEUT, u konfirmua mbështetja financiare e njësi bazë dhe e stafit akademik, lidhur me projektet kërkimore, botimin e artikujve shkencorë si dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore. Gjithashtu, për doktorantët që janë pjesë e personelit akademik të këtij fakulteti, për ndjekjen e studimeve të doktoraturës nuk do të paguajnë tarifën e studimeve por do të përballohet nga vetë institucioni.</p> <p>Në këtë kuadër, gjatë takimit me GVJ, u konfirmua se personeli akademik i këtij departamenti është mbështetur nga institucioni për organizimin dhe pjesëmarrjen në dy aktivitetet shkencore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Finance and Accounting towards Sustainable Development Goals” në bashkëpunim me Departamentin e Financës, FEUT dhe Departamentin e Menaxhimit, Universteti i Torinos, Itali; ▪ Workshop i organizuar nga Departamenti i Kontabilitetit për Fiskalizimin.

	<i>Dok. (Statuti i UT-së; Plani strategjik i kërkimit shkencor të UT-së, 2018-2022; Vendime të Senatit Akademik të UT-së; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021; Format për raportin vjetor për veprimtaritë e kryera të FEUT).</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8	
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar (<i>Rregullores së FEUT-së, Rregullores së programit të studimit, etj</i>), GVJ konstaton se; Fakulteti si njësi kryesore mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore dhe siguron bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore për realizimin e kërkimit shkencor që përmbush objektivat e këtij programi studimi. Kjo evidentohet referuar të dhënave për stafin akademik të këtij programi studimi me pjesëmarrjen e stafit të departamenteve të tjera si ai i Financës, Menaxhimit, Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar. Nga takimet me GVB u konfirmua se stafi i departamentit të kontabilitetit bashkëpunon me stafin e departamenteve të tjera në zbatimin e projekteve kërkimore-shkencore. Në këto bashkëpunime ka një përfshirje jo vetëm të stafit akademik, por edhe të studentëve të këtij programi studimi. <i>Dok. (Statuti i UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Marreveshjet e bashkepunimit; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021; Format për raportin vjetor për veprimtaritë e kryera të FEUT).</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar (<i>dosja e projekteve, etj</i>) si dhe në takimet e GVJ me P/Dep. dhe stafin akademik u konfirmua pjesëmarrja dhe angazhimi i stafit në projektet kërkimore-shkencore.

<p>dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Në vitin 2020, departamenti është fitues i projektit “Leading Towards Sustainable Gender Equality Planths in Research Institutions LeTSGEPs”, financuar nga BE, në kuadrin e projektit Horizon 2020, në bashkëpunim dhe me partnerë nga vende europiane.</p> <p>Në muajin Nëntor 2021, në bashkëpunim me Departamentin e Financës, FEUT dhe Departamentin e Menaxhimit, Universteti i Torinos, Itali, u organizua Konferenca Shkencore Ndërkombëtare” Finance and Accounting towards Sustainable Development Goals”. Aktualisht, Departamenti është i përfshirë në Projektin e Zhvillimit të Kontabilitetit në Sektorin Publik në Shqipëri, i cili mbështetet nga Banka Botërore dhe Sekretariati për Çështjet Ekonomike, Konfederata e Zvicrës (SECO) si dhe zbatohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.</p> <p><i>Dok. (Dosja e Projekteve; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021; Format për raportin vjetor për veprimtaritë e kryera të FEUT).</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Në takimet e realizuara me përfaqësuesit e Drejtorisë së Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë të FEUT, u confirmua pjesëmarrja e stafit akademik dhe studentëve në projekte kërkimore, konferenca shkencore të organizuara nga fakulteti, si dhe konferencat shkencore studentore të organizuara nga shoqatat studentore. Njësia kryesore/FEUT dhe njësitë bazë janë të përfshira në disa projekte kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe kanë një sërë marrëveshje me IAL jashtë vendit në kuadër të programeve Erasmus +, që mundësojnë mobilitete të stafit akademik dhe studentëve të këtij fakulteti. Gjithashtu në takimet e realizuara me stafin akademik dhe GVB, u confirmua se Dep. i Kontabilitetit, ka qenë i angazhuar në organizimin e konferencave shkencore mbi zhvillimet e fundit në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, problematikave dhe sfidave për të ardhmen e këtij profesioni. Në këto konferenca ka marrë pjesë stafi akademik, studentët si dhe profesionistë të fushës. Organizimi i konferencave dhe punimet e paraqitura në to paraqesin interes të veçantë për palët e interesit, duke trajtuar çështje të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, por shërbejnë edhe si një guidë dhe shtysë për studentët në kërkimet e tyre shkencore të mëtejshme si dhe për përgatitjen e mikrotezave.</p>

	<i>Dok. (Dosja e Projekteve; Konferencat shkencore të FEUT dhe Dep. Kontabilitetit; Dokumentacioni për mobilitetet e studentëve&stafi akademik Erasmus +, 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit u konstatua se Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore ka hartuar një udhëzues për zbatimin e teknikave inovative dhe interaktive dhe inovative të mësimdhënies. FEUT duke marrë shkas nga situata e pandemisë COVID 19, ka implementuar metoda të ndryshme të mësimdhënies si mësimi në auditor, mësimi online dhe mësimi i kombinuar. Zhvillimi i procesit mësimor bazohet në këto komponentë: (leksione në auditor, seminare, ushtrime, projekte/detyra kursi, praktika mësimore përmes programeve kompjuterike, puna në grup, esse, etj.) Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët, u konfirmua se gjatë periudhës së pandemisë COVID 19, FEUT ka zhvilluar mësimin online përmes plattformës mësimore Google Classroom dhe më pas me platfromën MS Teams, i cili vazhdon të përdoret aktualisht nga stafi akademik dhe studentët.

	<p>Zhvillimi i mësimit dhe sezonit të provimeve mbështetet në rregulloren e FEUT dhe rregulloren e programit të studimit. <i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Guidë për zbatimin e teknikave inovative&interaktive të mësimdhënies_FEUT; Rregullore e posaçme për zhvillimin e provimeve online_UT).</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ, duke analizuar dokumentacionin shoqërues, konstaton se strukturat përgjegjëse të UT-së bazuar në kërkesat e Ligjit nr. 80/2015, “Mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UT-së; Rregulloren e UT/FEUT; Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në UT_së, me vendim të Senatit Akademik të UT-së, nr. 7, datë 26.03.2018, kanë ngritur grupin e punës për përgatitjen e manualit për vlerësimin e performancës të personelit akademik të UT-së.</p> <p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet në mënyrë periodike nga UT/FEUT dhe nga departamentet përkatëse.</p> <p>Në FEUT, ushtron veprimtarinë dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës si një strukturë përgjegjëse për vlerësimin e efikasitetit dhe cilësisë së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore si dhe veprimtarive të tjera administrative për programet e studimit.</p> <p>Në takimin e realizuar nga GVJ me përfaqësues të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrës Së Sigurimit të Cilësisë, u konfirmua se këto struktura kanë filluar veprimtarinë e tyre gjatë vitit 2022. Qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së tyre është vlerësimi i performancës dhe cilësisë së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore si dhe veprimtarive të tjera administrative të personelit akademik në njësitë bazë përmes paketës së instrumentave të cilësisë. Për këtë qëllim është hartuar dhe miratuar nga Senati Akademik, “Paketa e instrumentave të cilësisë në UT” në vitin 2020. Për plotësimin e saj, angazhohet Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë FEUT e cila përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Vlerësimi i procesit të mësimdhënies nga studentët.</i> Në përfundim të çdo semestri, realizohet pyetësori me studentët sa i përket zhvillimit të procesit mësimor. Pasi përpunohen të dhënat dhe nxirret rezultati, grupi i punës përgatit një raport, të cilin e vendos në dispozicion të departamenteve

	<p>përkatëse. Rezultatet e këtij pyetësoi janë pjesë e analizës vjetore njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Raport i vlerësimi të procesit të mësimdhënies nga stafi akademik.</i> Instrumenti i dytë që përdoret për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse të personelit akademik. Ky dokument plotësohet në përfundim të çdo viti akademik nga personeli akademik efektiv në bashkëpunim me përgjegjësit e grupeve mësimore dhe kërkimore shkencore dhe drejtuesit e departamentit. ▪ <i>Dokumentacioni i ngarkesës mësimore dhe intelektuale të stafit akademik.</i> Instrumenti i tretë që përdoret, është dokumenti i performancës akademike, ku stafi akademik dokumenton ngarkesën mësimore, performancën në kërkim shkencor, botime si dhe shërbimet ndaj të tretëve. Institucioni i jep një rëndësi të veçantë realizimit dhe plotësimit të pyetësorit me studentët, duke lejuar në këtë mënyrë përfshirjen e tyre në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pasi përpunohen të dhënat, grupi i punës përgatit një raport, të cilin ia përcjell departamenteve përkatëse. Rezultatet e këtij pyetësoi janë pjesë e analizës vjetore të njësisë kryesore dhe asaj bazë. <p><i>Dok. (Statuti i UT-së, neni 41; Rregullore e UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT_2020; Manuali për vlerësimin e performancës së personelit akademik_UT_2021; Paketa e instrumenteve të cilësisë_UT_2020).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në takimin e realizuar nga GVJ me përfaqësues të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, u konfirmua përfshirja e studentëve për vlerësimin e zhvillimit të procesit të mësimdhënies. Në përfundim të çdo semestri, realizohet pyetësoi me studentët sa i përket zhvillimit të procesit mësimor. Pasi përpunohen të dhënat dhe nxirret rezultati, grupi i punës përgatit një raport, të cilin e vendos në dispozicion të departamenteve përkatëse. Rezultatet e këtij pyetësoi janë pjesë e analizës vjetore njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p> <p><i>Dok. (Statuti i UT-së, neni 41 dhe 125; Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT_2020; Manuali i Cilësisë i UT-së; Paketa e instrumenteve të cilësisë_UT_2020; Manuali për vlerësimin e performancës së personelit akademik_UT_2021).</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, GVJ, konstatoi se objekti</p>



<p>cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>i veprimtarisë së kësaj dege, është vlerësimi i performancës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore si dhe veprimtarive të tjera administrative së personelit akademik. DSBCK i përcjell përgjegjësit të departamentit, rezultatet e vlerësimit për stafin akademik nga studentët për procesin e mësimdhënies. Organizimi, funksionimi dhe përgjegjësia e NJSBC, përcaktohen në Statutin e UT-së, Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë së UT-së. <i>Dok. (Statuti i UT-së, neni 139; Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT_2020; Manuali i Cilësisë i UT-së; Veprimtaria e Njesisë së brendshme të sigurimit të cilësisë FEUT_2021).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Në takimin e realizuar nga GVJ me përfaqësues të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, u konfirmua se rezultatet e anketave/pyetsorëve duke përfshirë edhe komentet përkatëse të bëra nga studentët, u përcillen departamenteve përkatëse të cilat më pas diskutohen në mbledhjet e departamentit me sfafin akademik. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, referuar qëllimit të veprimtarisë të saj, evidenton dhe promovon praktikat më të mira në procesin e mësimdhënies dhe në kërkimin shkencor në nivel fakulteti. <i>Dok. (Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT_2020; Manuali i Cilësisë i UT-së; Veprimtaria e Njesisë së brendshme të sigurimit të cilësisë FEUT_2021; Manuali për vlerësimin e performancës së personelit akademik UT_2021).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues (<i>dosjes së programit të studimit, rregullores, kurikulës dhe planit mësimor, syllabusët e lëndëve</i>) GVJ konstaton se; në programin e studimeve Master i Shkencave, në “Kontabilitet dhe Auditim” metodat kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminare, ushtrime, detyra</p>

profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.

kursi/projekte, praktika mësimore, puna në grup dhe në laborator, etj në varësi të llojit të lëndës. Metodatat e transmetimit të njohurive tek studentët janë bashkëkohore në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies. Përdorimi i metodave inovative, përfshirja e mjete bashkëkohore, (si pajisje audio-vizive) apo edhe aplikacione të ndryshme që mundësojnë realizimin e aktiviteteve të mësimin ndikon në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Nga biseda e realizuar me studentët e këtij programi kuptuam se zhvillimi i leksioneve interaktive i lejon ata të përfshihen më tepër në diskutime gjatë orës së mësimin, si në leksion apo seminar. Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma parashikohen në planet mësimore, programet e moduleve, dhe rregulloren e programit të studimit.

Format e mësimin teorik e praktik janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat/projektet e kursit, punët laboratorike, praktikat profesionale, etj. Në përfundim të secilit modul është parashikuar zhvillimi i provimit përkatës. Modulet klasifikohen në dy grupe kryesore: module të detyruara dhe module me zgjedhje. Format e kontrollit të dijeve: provimet ndërmjetëse, aktivizime dhe diskutime gjatë seminarëve; përgatitja dhe mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet përfundimtare, dhe përgatitja dhe mbrojtja e temave të diplomave.

Format dhe elementët e mësimdhënies për këtë program studimi, referuar planit mësimor dhe tabelave për ngarkesën mësimore përfshijnë: (leksione, seminare, ushtrime, projekte/detyra kursi, praktika profesionale, mikroteza/tema e diplomës).

Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat e VKM Nr.41 dhe përbëhet nga:

- Lëndët bazë të kategorisë A : (1 lëndë, 7 kredite),
- Lëndët karakterizuese të kategorisë B: (11 lëndë, 67 kredite),
- Lëndët ndërdisiplinore/integruese të kategorisë C: (3 lëndë, 16 kredite),
- Lëndët plotësuese të kategorisë D: (praktika profesionale, 12 kredite),
- Detyrimet përmbyllëse të kategorisë E: (mikroteza, 18 kredite).

	<p>Në total 120 kredite/2 vite akademike.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Plani Mesimor; Syllabuset e lëndëve; VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga instucionet e arsimit të lartë”, Ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019; Nr. 185, datë 25.3.2021).</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit shoqërues (<i>Rregullores së programit të studimit, kurikulës dhe planit mësimor</i>), GVJ konstaton se; ky program studimi ndërthur njohuritë teorike me ato praktike, për të inkurajuar tek studentët mendimin krijues dhe kritik si dhe për ti pajisur ata më njohuri të thelluara në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Gjithashtu nga takimi me stafin akademik u konfirmua se, synohet nxitja dhe zhvillimi i mësimit në mënyrë interaktive me studentët gjatë zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, duke pasur në konsideratë edhe elementët e vlerësimit, si aktivizimi, diskutimi, puna individuale/grup, detyra/projekte kursi, etj. Personeli akademik i Departamentit të Kontabilitetit për këtë program studimi i përgjigjet nevojave të studentëve duke ofruar forma dhe metoda alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Një shembull i tillë është zhvillimi i mësimit përmes platformave mësimore online gjatë periudhës së pandemisë.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>GVJ, duke analizuar dokumentat strategjike të UT-së, (<i>Statuti i UT-së, Plani Strategjik i Kërkimit Shkencor të UT-së, etj.</i>) konstatoi se, institucioni mbështet dhe investon në fuqizimin e kërkuesve shkencorë përmes forcimit të njohurive për mundësitë që ata kanë për të zhvilluar më tej karrierën e tyre akademike brenda dhe jashtë institucionit. Nga vizita e realizuar në ambjentet e FEUT-s rezultoi se në funksion të këtij program studimi janë vënë në dispozicion të studentëve salla të pajisura me kompjutera dhe programe kompjuterike (alpha web, SPSS, Bilanc, etj). Këto kapacitete krijojnë mundësi edhe për personelin akademik për të përdorur metoda dhe për të krijuar një mjedis më të favorshëm në funksion të transferimit të dijeve tek studentët. Në përfundim të studimeve, programi synon që studenti të përfitojë njohuri dhe aftësi të thelluara teorike nga njëra anë dhe nga ana tjetër aftësi praktike për përshtatjen e tyre sa më mirë në tregun e punës.</p>


	<p><i>Dok. (Statuti i UT-së; Plani strategjik i kërkimit shkencor të UT-së, 2018-2022; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Foto të mjediseve të FEUT; Tabela për kapacitetet infrastrukturore të sallave, laboratorëve dhe pajisjeve/FEUT).</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i të dhënave për personelin akademik GVJ, konstatoi se, institucioni bazuar në Statutin, Plani strategjik të kërkimit shkencor të UT-së; u kushton rëndësi procesit dhe kriterëve për rekrutimin e personelit akademik. Statuti i UT-së përcakton kriteret e përgjithshme për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Nga shqyrtimi i CV-ve, personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” përmbush të gjitha kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>Aktualisht, stafi akademik që mbulon këtë program studimi, për vitin akademik 2021-2022, ka në përbërjen e tij një staf akademik prej 38 pedagogë (PAE dhe PAK), nga të cilët 4 janë me titullin Prof. Dr, 6 janë me titullin Prof. As. Dr., 16 janë me gradën shkencore “Doktor” të kategorisë lektorë dhe 12 të kategorisë asistentë lektorë me MSc nga të cilët 6 ndjekin studimet e ciklit të tretë të doktoratës. Nga takimi me P/Dep, u theksua se përfshirja e asistent/lektorëve me MSc, është kryesisht në zhvillimin e seminareve dhe ushtrimeve, si një mundësi për karrierën e tyre akademike dhe profesionale dhe për të siguruar vijimësinë e programit të studimit në nivele të larta profesionale. I gjithë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi mban titujt profesor dhe gradën doktor, pra një grade më lartë sesa cikli i studimit ku japin mësim. Personeli akademik në këtë program studimi referuar dokumentacionit shoqërues angazhohet në projekte, marrin pjesë në konferenca shkencore si dhe kanë realizuar botime në revista shkencore. Fusha kërkimore-shkencore e secilit nga anëtarët e këtij stafi është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku ata zhvillojnë mësim.</p> <p><i>Dok. (Statuti i UT-së, neni 67 dhe 68; Plani strategjik i kërkimit shkencor të UT-së, 2018-2022; CV e Personelit Akademik; Të dhëna tabelore për personelin akademik në njesinë kryesore dhe njesinë përgjegjëse/ bazë 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021).</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në takimin e realizuar nga GVJ me përfaqësues të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës si dhe Zyrës së Sigurimit të Cilësisë, u konfirmua se institucioni përmes strukturave përkatëse ofron përfshirjen e studentëve përmes instrumentave të ndryshëm (anketimet, pyetsorët) në vlerësimin periodik të procesit mësimor. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të UT dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e FEUT, kanë përgjegjësinë për hartimin dhe plotësimin e pyetsorëve nga studentët përpara dy sezoneve të provimeve për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor për lëndët e çdo programi studimi. DSBC i dërgon përgjegjësit të departamentit, rezultatet e vlerësimit nga studentët për procesin e mësimdhënies sipas lëndëve përkatëse. Në mbledhjen e departamentit, këto rezultate u komunikohen stafit akademik për të analizuar problemetikat që duhen përmirësuar në të ardhmen. FEUT në mënyrë të vazhdueshme ka përmirësuar metodat e mesimdhënies duke marrë në konsideratë zhvillimet në nivel kombëtar si edhe duke përfshirë studentët në këtë process, nëpërmjet plotësimit të pyetsorëve dhe kur ka qenë e nevojshme kanë reflektuar mendimet dhe sugjerimet e tyre. <i>Dok. (Statuti i UT-së; Manuali i Cilësisë i UT-së; Paketa e instrumenteve të cilësisë_UT_2020; Rregullore për sigurimin e cilesisë_UT_2020).</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues (Rregullores së UT/FEUT-së; Rregullores së Programit të Studimit), GVJ konstaton se; Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore për të implementuar metodat e reja të mësimdhënies ka hartuar një udhëzues për zbatimin e teknikave inovative dhe interaktive dhe inovative të mësimdhënies. FEUT dukë marrë shkas nga situata e pandemisë COVID 19, ka përshtatur metoda të ndryshme të mësimdhënies si mësimi në auditor, mësimi online dhe mësimi i kombinuar.</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët, u theksua se gjatë periudhës së pandemisë, FEUT ka zhvilluar procesin mësimor përmes platformës mësimore Google Classroom dhe më pas me platformën MS Teams, e cila vazhdon të përdoret aktualisht nga stafi akademik dhe studentët. Gjithashtu përdorimi i metodave inovative si E-Learning është një mundësi e mirë, për trajnimin e vazhdueshëm, dhënien e njohurive, zhvillimin e mësimdhënies, në një mënyrë innovative duke shfrytëzuar teknologjinë e</p>

	<p>informacionit si pajisjet kompjuterike, etj në mjediset akademike. Për të bërë orën e mësimit sa më tërheqëse, personeli akademik përdor metoda të ndryshme interaktive duke përfshirë dhe studentët. Në këtë mënyrë mësimi zhvillohet jo vetëm në formën standarde të shpjegimit të koncepteve themelore të lëndës, por edhe pjesëmarrjes dhe diskutimeve midis grupeve të studentëve, zhvillimit të rasteve studimore nga praktika vendase dhe botërore më qëllim thellimin teorik po edhe zbatimin praktik të njohurive të marra. Nëpërmjet detyrave/projekteve të ndryshme që caktohen, studentët udhëzohen dhe mbështeten nga personeli. Bashkëpunimi i ndërsjelltë pedagog-studentë vihet re jo vetëm në procesin e përjavshëm të zhvillimit të mësimit, por edhe në procesin e punës për realizimin dhe përgatitjen e mikrotezës, duke filluar me zgjedhjen e temës, mbledhjen e informacionit, përpunimin dhe analizën e rezultateve, deri në finalizimin me sukses të këtij procesi.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e UT; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Guidë për zbatimin e teknikave inovative&interaktive të mësimitdhënies_FEUT).</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nga përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.3	
<p>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimitdhënies, mësimitnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit <i>shoqërues (Të dhëna për kapacitetet infrastrukturore të sallave, laboratorëve dhe pajisjeve/FEUT) GVJ</i> konstaton se; Fakulteti i Ekonomisë i UT-së, ka hapësira të mjaftueshme dhe cilësore për zhvillimin e procesit për këtë program studimi. Procesi mësimor për programin e studimeve Bachelor dhe Master zhvillohet pranë ambienteve të Fakultetit të Ekonomisë, të ndara në dy godina kryesore, Godina A dhe Godina B.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për</p>	

Web site: www.ascal.al



<p>realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Gjithashtu nga vizita ne institucion, GVJ konstaton se: stafi akademik dhe ai administrativ kanë ambientet e tyre të pajisura me mjete dhe teknologji bashkëkohore për t'i shërbyer sa më mirë procesit mësimor dhe nevojave të studentëve. Sallat dhe klasat e FEUT-së janë të pajisura me teknkologjinë e duhur për të lehtësuar zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, aktivitetet e punës në grup të studentëve, sallat e laboratorëve janë të pajisur me kompjuter, projektorë. Të dhënat për mjediset e fakultetit për programin e studimit sipas <i>(dokumentacionit shoqërues te dhena tabelore per personelin akademik ne njesine kryesore dhe njesine pergjegjese/baze)</i> janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 27 salla për leksione, me sipërfaqe 2752.4 m²; - 22 salla për seminare, me sipërfaqe 1028.4 m²; - 4 laboratorë, me sipërfaqe 188.2 m²; - 7 laboratorë informatike, me sipërfaqe 453.3 m²; - 2 salla për bibliotekë, me sipërfaqe 525.1 m²; <p>Nga vizita e realizuar në ambientet e Fakultetit konstatuam se mjediset ku zhvillohet mësimi plotësojnë kriteret e nevojshme për të zhvilluar një proces sa më cilësor të mësimdhënies. Në këto mjedise gjejmë mjete mësimore të duhura (kompjuterat, Lap-Top, video-projektorë, etj) që lejojnë një zhvillim normal të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i IT-së. Programet kompjuterike janë instaluar në përshtatje programeve mësimore duke instaluar programet aplikative sipas fushave që mbulon departamenti përgjegjës për këtë program studimi. Gjithashtu, mundësimi i sistemit wireless në mjediset e Fakultetit ndihmon stafin akademik dhe studentët në përmirësimin e këtij procesi. Nga nga të dhënat e mësipërme GVJ konstaton se, FEUT i plotëson kërkesat ligjore për kapacitetet infrastrukturore për zhvillimin e procesit mësimor. <i>Dok. (Të dhëna tabelore për personelin akademik në njesinë kryesore dhe njesinë pergjegjëse/ bazë 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022, Tabela 13; Foto të mjediseve të FEUT; Tabela për kapacitetet infrastrukturore të sallave, laboratorëve dhe pajisjeve/FEUT).</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të</p>	<p>Nga vizita në mjediset e FEUT-së, GVJ konstaton se; për realizimin e procesit mësimor, personeli akademik dhe studentët përdorin laboratorët të cilët janë të pajisur me kompjuter dhe kanë të instaluar programet përkatëse si alpha</p>

<p>nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>web, Bilanc, Microsoft office, SPSS, etj për realizimin e praktikave mësimore dhe për ti shërbyer sa më mirë procesit mësimor. Zyrat e personelit akademikë dhe administrativë janë të pajisura me kompjutera dhe internet, për t'i shërbyer sa më mirë procesit mësimor dhe nevojave të studentëve.</p> <p><i>Dok. (Të dhëna tabelore për personelin akademik në njesinë kryesore dhe njesinë përgjegjëse/ bazë 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022, Tabela 13; Foto të mjediseve të FEUT; Tabela për kapacitetet infrastrukturore të sallave, laboratorëve dhe pajisjeve/FEUT)</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, literatura bazë e përdorur në modulet e këtij programi studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore që u ofrohet studentëve, në vartësi të modulit, përfshin: tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt, materiale në ëeb, artikujve, etj. Nga shqyrtimi i syllabuseve të këtij programi studimi, rezulton se literatura, qoftë bazë apo ndihmëse, garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në mjediset e FEUT-së, u konstatua se; për realizimin e procesit mësimor, biblioteka qendrore e FEUT-së luan një rol të rëndësishëm duke mbështetur me literaturë shtesë studentët për procesin mësimor dhe kërkimor shkëncor. Misioni dhe qëllimi i bibliotekës së FEUT është që të plotësojë nevojat e studentëve dhe stafit akademik me materiale dhe informacione në funksion të programit mësimor. Literatura bazë ofrohet nga tekstet ose leksione te printuara që gjenden në binbliotekë, fotokopje të leksioneve disponohen nga libraria e institucionit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues (Dokumente “Informacion për bibliotekën Joseph Limprecht”), hapësirat e bibliotekës janë të mjaftueshme që përbëhen nga dy salla studimi me një kapacitet prej 200 vende dhe një sipërfaqe prej 525.1 m². Biblioteka “Joseph Limprecht” ka në fondin e saj rreth 52589 tituj (libra, revista, doktoratura, mikroteza etj.), nga të cilat 2526 tituj në gjuhën shqipe dhe 2754 libra në gjuhë të huaj. Pasurimi i bibliotekës bëhet çdo vit, bazuar në kërkest e personelit akademik, propozimit të përgjegjesit të bibliotekës dhe të miratimit nga dekani i njesisë kryesore. Kjo bibliotekë është në shërbim të studentëve nga e Hëna deri ditën e Premte, ndërsa gjatë sezonit të provimeve qëndron e hapur edhe ditën e Shtunë dhe ditën e Diel. Mjediset për fotokopje dhe librari</p>

	<p>janë afërsisht 71.3 m², që janë pjesë e mjediseve të FEUT. Përveç literaturës dhe materialeve fizike të cilat ofrohen në librarinë e FEUT, institucioni ofron edhe materialet përmes librarisë elektronike JSTOR dhe Ulibrary_RASH.</p> <p><i>Dok. (Statuti i UT-së, neni 28; Plani strategjik i kerkimit shkencor të UT-së, 2018-2022; Syllabuset e Lëndëve; Të dhëna tabelore për personelin akademik në njesinë kryesore dhe njesinë pergjegjëse/ bazë 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022, Tabela 13; Dokumente "Informacion për bibliotekën Joseph Limprecht", Manual përdorimi Ulibrary_RASH).</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues si dhe gjatë vizitës dhe takimit të GVJ me punonjësit e bibliotekës u konfirmua se në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët e FEUT aksesojnë libraritë elektronike JSTOR dhe Ulibrary_RASH. I gjithë stafi akademik mund ta aksesojë këtë librari nga zyrat e tyre, ndërkohë që studentët mund ta aksesojnë nga biblioteka. Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim ka nënshkruar marrëveshjen për abonimin në bibliotekën elektronike JSTOR. Kjo library ofron më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe 2 milion dokumente për 75 disiplina. Ulibrary ofrohet nga projekti për Krijimin e Qendrës Ndëruniversitare të Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik Universitar". Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë "Joseph Limprecht" është bërë pjesë e Proqramit COBISS +, ku u mundëson bibliotekave dhe përdoruesve akses online në bazën e përbashkët të dhënave, bazën locale të dhanëve si dhe burime të tjera të informacionit. COBISS + është krijuar për tu shërbyer kërkuesve shkencorë, studentëve, stafit akademik, për të gjithë ata që kërkojnë informacione dhe materiale (edhe elektronike) të disponueshme në bibliotekën akademike. Gjithashtunë funksion të personelit akademik dhe studentëve është edhe platforma online Microsoft Teams.</p> <p><i>Dok. (Dokumente "Informacion për bibliotekën Joseph Limprecht", Biblioteka dixhitale JSTOR; Manual përdorimi Ulibrary_RASH).</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe</p>	<p>Në takimin e realizuar me P/Dep. dhe stafin akademik u konfirmua se procesi mësimor për këtë programi studimi, zhvillohet në të gjitha mjediset që janë në dispozicion nga FEUT. Gjithashtu sallat e laboratorëve u shërbejnë studentëve</p>

<p>studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>për kryerjen e praktikave mësimore. Studentët mund të shfrytëzojnë aksesin në internet përmes pajisjeve wireless në të mjediset e FEUT.</p> <p><i>Dok. (Të dhëna tabelore për personelin akademik në njesinë kryesore dhe njesinë përgjegjëse/ bazë 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022, Tabela 13; Foto të mjedisëve të FEUT; Tabela për kapacitetet infrastrukturore të sallave, laboratorëve dhe pajisjeve/FEUT).</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në takimin e realizuar me P.Dep., stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, u konfirmua se gjatë periudhës së pandemisë COVID 19, procesi mësimor u zhvillua përmes platformave online Google Classroom dhe MS Teams. Çdo student dhe pedagog është pajisur me kredencialet e veta për përdorimin e këtyre platformave online. MS Teams është përdorur gjatë periudhës së pandemisë për zhvillimin e mësimin dhe provimeve online, ndërsa aktualisht përdoret për komunikimin midis stafit akademik dhe studentëve.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e UT; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Guidë për zbatimin e teknikave inovative&interaktive të mësimdhënies FEUT).</i></p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>FEUT aktualisht, nuk përdor dhe zbaton një strukturë të teknologjisë së informacionit që menaxhon IAL në vend.</p> <p><i>Nga takimet me stafin akademik dhe studentët u konfirmua që sistemi e-student nuk është në funksion si rezultat i Upgrade të bazës së të dhënve të këtij sistemi.</i> Komunikimi midis stafit akademik dhe studentëve realizohet platformës MS Teams si dhe website personal të tyre, duke mundur në këtë mënyrë marrjen e informacionit në distancë nga studentët.</p> <p><i>Dok. (Manual përdorimi e-studentë&pedagog UT).</i></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqëruar (<i>Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit, etj.</i>) GVJ konstatoi se; Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti. Procesi i përcaktimit të pedagogut udhëheqës ndiqet në mënyrë të kujdesshme nga një grup pedagogësh të departamentit. Departamenti ka krijuar një grup pune i përbërë nga stafi akademik dhe ndihmës akademik, i cili është përgjegjës për këshillimin, orientimin dhe udhëheqjen e studentëve për realizimin e mikrotezës. Grupi i punës ka krijuar postën elektronike për të komunikuar me studentët, për</p>

	<p>shpërndarjen e informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm për përgatitjen e mikrotezes. Kjo postë elektronike ka shërbyer si mënyrë komunikimi në vazhdimësi midis studentit dhe pedagogut udhëheqës, i cili mbikëqyr dhe udhëheq studentin në gjatë përgatitjes së mikrotezës. Pedagogu udhëheqës në bashkëpunim me studentin, përgatit programin e punës, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të saj. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura duke bërë të mundur përgatitjen e mikrotezes dhe mbrojtjen me sukses të temës së diplomës.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Korrespondenca me studentet për përgatitjen e mikrotezës; Dosja e udhëheqjes së temave të diplomave).</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vëtdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ, duke analizuar dokumentat strategjike të institucionit, (<i>Statuti i UT-së, Plani Strategjik i Kërkimit Shkencor, etj.</i>), konstaton se UT ka krijuar dhe organizon në nivel institucional njësitë që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Këto njësi ndihmëse janë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe në funksion të procesit mësimor-kërkimor. Pranë FEUT si njësi kryesore, funksion Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës dhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë si struktura përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore për programet e studimit.</p>

	<i>Dok. (Statuti i UT-së; Rregullore për sigurimin e cilesisë UT_2020; Plani strategjik i kërkimit shkencor të UT-së, 2018-2022).</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	<p>Departamenti i Kontabilitetit është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”. Në takimin e realizuar me P/Departamentit dhe stafin akademik, u konfirmua përdorimi i formave dhe metodave të reja inovative për zhvillimin e procesit mësimor, përmes pjesëmarrjes së tyre në trajnime, projekte dhe mobilitete në kuadër të programeve Erasmus +.</p> <p>Nga takimi me dekanin e FEUT, u konfirmua se gjatë periudhës Maj-Qershor 2022, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, organizuan trajnimin pedagogjik për stafin e ri akademik të FEUT në fushën e pedagogjisë dhe metodave të mësimdhënies. Një praktikë tjetër e rëndësishme e ndjekur nga Departamenti janë edhe leksionet e hapura që zhvillohen nga lektorë vendas, si profesionistë të fushës së kontabilitetit dhe auditimit në Shqipëri, por edhe lektorë të huaj, të ftuar në kuadër të programeve Erasmus + nga universitete perëndimore.</p> <p><i>Dok. (Statuti i UT-së; Plani strategjik i kërkimit shkencor të UT-së, 2018-2022; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit MSh_KA Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Dokumentacioni për mobilitetet Erasmus+; https://feut.edu.al/lajmerime/1381-leksion-i-hapur-ne-fe-me-teme-what-is-erp-why-do-we-need-erp).</i></p>
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit strategjik të institucionit, (Statuti i UT-së, Plani Strategjik i Kërkimit Shkencor, etj.), institucioni parashikon mbështetje financiare për kërkimin shkencor të stafit akademik nëpërmjet vendimeve të senatit akademik. Departamenti i Kontabilitetit si njësi përgjegjëse për këtë program studimi nxit dhe mbështet pjesëmarrjen e stafit akademik në procesin kërkimor dhe shkencor.</p>
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	<p>Gjatë takimit me GVJ dhe stafin akademik, u konfirmua se personeli akademik i këtij departamenti është mbështetur nga institucioni për organizimin dhe pjesëmarrjen në dy aktivitetete shkencore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Finance and Accounting towards Sustainable Development Goals” në bashkëpunim me Departamentin e Financës, FEUT dhe Departamentin e Menaxhimit, Universtieti i Torinos, Itali;

	<ul style="list-style-type: none"> Workshop i organizuar nga Departamenti i Kontabilitetit për Fiskalizimin. <p>Personeli akademik i Departamentit ka treguar arritje të kënaqshme në fushën e kërkimit shkencor. Ky fakt mbështetet në numrin e kënaqshëm të artikujve shkencorë të botuar në revista të huaja të njohura si edhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare organizuar brenda dhe jashtë vendit. Siç u përmend edhe më sipër në prioritetin e strategjisë së UT, kualifikimi i personelit akademik në fushën e kërkimit ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies.</p> <p><i>Dok. (Statuti i UT-së; Plani strategjik i kerkimit shkencor të UT-së, 2018-2022; Vendim; "Udhezimi për procedurat e administrimit te projekteve të kerkimit shkencor UT" 2021; Vendim për miratimin e ngritjes së Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në UT 2021; Të dhëna tabelore për personelin akademik në njesinë kryesore dhe njesinë përgjegjëse/bazë 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022, Tabela 17; Konferencat shkencore të FEUT dhe Dep. Kontabilitetit; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021)</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Departamenti i Kontabilitetit është njësi bazë përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Kontabilitet dhe Auditim".</p> <p>Gjatë takimit me P/Departamentit dhe stafin akademik, u konfirmua angazhimi i personelit akademik në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies si dhe zbatimin e metodave alternative në funksion të përcjelljes sa më mirë të njohurive tek studentët përmes pjesëmarrjes së tyre në trajnime, projekte dhe mobilitete në kuadër të programeve Erasmus +.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjithashtu referuar bashkëpunimit që ka FEUT dhe departamenti me një sërë organizatash profesionale, si dhe institucione publike, personeli akademik është trajnuar në përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit MSh_KA; Manuali i Cilësisë i UT-së; Manuali për vlerësimin e performancës së personelit akademik UT 2021).</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqerues (Marrëveshjet e bashkëpunimit, etj), si dhe gjatë takimit me P/Dep. dhe stafin akademik u konfirmua se Departamenti i Kontabilitetit si njësi</p>

në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor

bazë përgjegjëse për këtë programi studimi për lëndë/module të veçanta me karakter aplikativ fton specialistë të fushës për të përcjell tek studentët zhvillimet më të reja në fushat përkatëse. Kështu mund të përmendet specialistët e ftuar nga DPT, KLSH, Ministria e Financave, nga shoqëritë e auditimit dhe organizata profesionale. Gjithashtu në bazë të marrëveshjeve me FEUT, institucione të ndryshme si DPT, APP, kanë kërkuar kryerjen e konsulencës dhe ekspertizës nga stafi akademik i fakultetit, përfshirë dhe Departamentin e Kontabilitetit, si dhe trajnimin e personelit të tyre në fusha të caktuara. Në kuadër të programeve Erasmus+, personeli akademik i FEUT-së dhe departamentit ka një bashkëpunim dhe partneritet të suksesshëm me kolegë të universiteteve të tjera homologe në rajon dhe në Europë. Një praktikë tjetër e rëndësishme e ndjekur nga Departamenti janë edhe leksionet e hapura që zhvillohen nga lektorë vendas, si profesionistë të fushës së kontabilitetit dhe auditimit në Shqipëri, por edhe lektorë të huaj, të ftuar në kuadër të programeve Erasmus+ nga universitete perëndimore.

Këto bashkëpunimeve dhe shkëmbime eksperiencash ndikojnë në cilësinë e performancës së personelit por edhe ngritjen në një nivel më të lartë të transmetimit të dijeve tek studentët (praktika të reja të mësimdhënies, metoda të reja mësimdhënie, forma të reja të përfshirjes së studentëve në diskutime, etj.). Ky fakt u pohua edhe nga pedagogët dhe studentët e këtij program studimi gjatë takimit të realizuar me ta.

Dok. (Statuti i UT-së; Plani strategjik i kerkimit shkencor të UT-së, 2018-2022; Mareveshjet e bashkëpunimit; Marreveshjet në kuadër të programeve Erasmus +; Veprimtaria e Zyrës Karrierës; <https://feut.edu.al/lajmerime/1381-leksion-i-hapur-ne-fe-me-teme-what-is-erp-why-do-we-need-erp>).

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.5


Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues GVJ konstatoi se; kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e UT/FEUT-së, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”.</p> <p>Bazuar në këto rregullore, format e kontrollit dhe vlerësimit, të njohurive dhe dijeve përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mënyrat e kontrollit dhe vlerësimit, përcaktohen në programin dhe syllabuset e lëndëve dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor; ▪ Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e dijeve që ka përvetësuar studenti gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli janë: provimi i ndërmjetëm, aktivizimi dhe diskutimi në seminare, projektet/detyrat e kursit, esse/raste studimore dhe provimi përfundimtar; ▪ Tezat e provimit hartohen nga titullari i modulit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit në përputhje me syllabusin e lëndës; ▪ Provimet e ndërmjetme janë elementë të vlerësimit të vazhduar. Ato zhvillohen në javën e shtatë/tetë të çdo semestri; ▪ Provimi përfundimtar zhvillohet në fund të çdo semestri. Kohëzgjatja e zhvillimit të provimit bëhet e njohur përpara fillimit të provimit. Provimi me shkrim zhvillohet me procedurë sekretimi në përputhje me rregulloren e FEUT-së; ▪ Në format e kontrollit dhe vlerësimit, përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit përkthehet në note; <p>Për provimin e ndërmjetëm, rishikimi i tezes bëhet pas shpalljes së rezultateve, gjatë orës së parë të seminarit, ndërsa për provimin përfundimtar procesi i korigjimit dhe vlerësimit përfundon brenda 15 ditë pune, qe nga data e zhvillimit të provimit. Ky afat përfshin, korigjimin, vlerësimin, shpalljen e rezultateve, rishikimin e provimeve dhe dorëzimin e procesverbaleve në sekretarinë mësimore. Në sekretarinë mësimore, pedagogët e lëndës së bashku me procesverbalet e notave, dorëzojnë edhe pasqyrën sipas elementëve përbërs të vlerësimit.</p> <p><i>Dok. (Statuti i UT-së, neni 104; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT, Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët</p>	

informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga analiza e dokumentacionit shoqërues (<i>Rregullorja e Programit të Studimit; Syllabuset e Lëndëve</i>), si dhe gjatë takimit të GVJ me stafin akademik u konfirmua se; format e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, i bëhen me dije studentit në javën e parë të fillimit të mësimit nga pedagogu përgjegjës i lëndës/modulit përkatës. Vlerësimi i dijeve të studentit, mbështetet në elementët e kontrollit të vazhdueshëm dhe të provimit përfundimtar. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm, vlerësuar me 100 pikë dhe konvertuar në notë.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Provimi i ndërmjetëm me shkrim (25-30%); ▪ Aktivizimi dhe diskutimi në seminare (10-15%); ▪ Punë individuale dhe në grup; detyra/projekte kursi, esse, etj (10-15%); ▪ Provimi përfundimtar me shkrim (jo më pak se 40%); Format dhe mënyrat e vlerësimit përcaktohen sipas programit të çdo lënde dhe miratohen përpara fillim të vitit akademik. <i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Syllabuset e lëndëve).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues (<i>Rregullorja e Programit të Studimit; Syllabuset e Lëndëve</i>), si dhe gjatë takimit të GVJ me stafin akademik u konfirmua se format dhe mënyrat e vlerësimit përcaktohen sipas programit të çdo lënde dhe miratohen nga Departamenti përpara fillim të vitit akademik. Vlerësimi i dijeve të studentit, mbështetet në elementët e kontrollit të vazhdueshëm (provimi i ndërmjetëm, aktivizimi dhe diskutimi në seminare, punë individuale dhe në grup; detyra/projekte kursi, esse, etj) dhe provimin përfundimtar. <i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Syllabuset e lëndëve).</i>



<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>) konstatoi se Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) ka nënshkruar një marrëveshje për aplikimin e projektit Clean Score, lidhur me korigjimin e provimeve të studentëve në mënyrë elektronike.</p> <p>Gjatë takimit me GVB, P/Departamentit dhe stafin akademik, u konfirmua se gjatë dy viteve akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 në kushtet e pandemisë Covid 19, FEUT ka përdorur metoda inovative për zhvillimin e procesit mësimor dhe provimeve online (platformat mësimore Google Classroom dhe Microsoft Teams). <i>Dok. (Rregullore e UT-së; Rregullore e posaçme e UT-së, mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online, viti akademik 2020-2021; Projekti Clean Score-AADF; Marrëveshjet e bashkëpunimit;).</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues GVJ konstatoi se; procedura që ndiqet dhe zbatohet për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentëve në provimin përfundimtar është e standardizuar në rregulloren e FEUT si dhe Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit në përputhje me syllabusin e lëndës. Komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Zv. Dekanin për mësimin. Çdo komision provimi përbëhet nga jo më pak se dy anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e UT-së, neni 46 dhe 48; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Urdher mbi procedurat e zhvillimit të provimeve FEUT 2016).</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues (<i>Rregulloren e FEUT si dhe Rregulloren e Programit të Studimit; Urdhër mbi procedurat e zhvillimit të provimeve FEUT</i>) si dhe nga takimi me stafin akademik u konfirmua se provimet me shkrim të studentëve, zhvillohen me procedurë sekretimi.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT Rregullore e Programit të Studimit MSh_KA; Urdher mbi procedurat e zhvillimit të provimeve FEUT 2016).</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues (<i>Rregulloren e UT/FEUT si dhe Rregulloren e Programit të Studimit</i>) si dhe nga takimi me stafin akademik u konfirmua se personeli akademik i</p>

<p>feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>angazhuar në këtë program studimi, në fillim të çdo semestri, prezanton elementët e vlerësimit përmes syllabusit të modulit përkatës, këshillon dhe orienton studentët në lidhje me kryerjen e detyrave/projekteve të kursit. Vlerësimi i detyrave/projekteve të kursit, provimeve, shoqërohet me komente për të ndihmuar studentin, të kuptojë sa ka arritur të përvetësojë nga lënda dhe ç'farë duhet të përmirësojë në të ardhmen. Vlerësimi me pikë shënohet në fletën e provimit dhe pasqyrën përmbledhëse të vlerësimit të studentëve, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën e provimit dhe depozitohet në në dosjen e provimit përkatës dhe arkivohet departament.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA).</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues (<i>Rregulloren e FEUT si dhe Rregulloren e Programit të Studimit; Urdhër mbi procedurat e zhvillimit të provimeve_FEUT</i>) si dhe nga takimi i GVJ me P. Dep dhe stafin akademik u konfirmua se pedagogët, zbatojnë në mënyrë korrekte kriteret dhe procedurat lidhur me zhvillimin e provimeve. Gjatë zhvillimit të provimit lejohet vetëm përdorimi i mjeteve ndihmëse. Në përputhje me rregulloret dhe Kodin e Etikës, studenti që në provim përdor forma dhe mjete të palejueshme përjashtohet nga provimi.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Urdhër mbi procedurat e zhvillimit të provimeve_FEUT_2016; Kodi i Etikës).</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Në zbatim të rregulloreve përkatëse (<i>Rregullore e UT/FEUT, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA, Urdhër mbi procedurat e zhvillimit të provimeve_FEUT</i>) si dhe nga takimi i GVJ me stafin akademik u konfirmua se korigjimi dhe vlerësimi i provimeve të studentëve bazohet gjithmonë në meritën dhe përgatitjen e studentëve dhe u komunikohet në afatin e përcaktuar në rregullore. Kur provimi zhvillohet me gojë, rezultatet e provimit, studentëve u bëhen të njohura nga komisioni në përfundim të provimit. Për provimin e ndërmjetëm, rishikimi i tezës bëhet pas shpalljes së rezultateve, gjatë orës së parë të seminarit, ndërsa për provimin përfundimtar procesi i korigjimit dhe vlerësimit përfundon brenda 15 ditë pune, që nga data e zhvillimit të provimit. Ky afat përfshin, korigjimin, vlerësimin, shpalljen e rezultateve, rishikimin e provimeve dhe dorëzimin e procesverbaleve në sekretarinë mësimore. Në sekretarinë mësimore, pedagogët e lëndës së bashku me procesverbalet e</p>

	notave, dorëzojnë edhe pasqyrën sipas elementëve përbërs të vlerësimit. <i>Dok. (Rregullore e UT-së, Rregullore e Njesisë Kryesore/FEUT, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Urdher mbi procedurat e zhvillimit të provimeve_FEUT_2016).</i>								
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në zbatim të rregullores së UT/FEUT-së, institucioni, garanton të drejtën studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit. Studenti ka të drejtën të paraqesë ankesë me shkrim, përgjegjesit të departamentit për problematikat lidhur me procedurat e vlerësimit dhe rezultatet e provimit. Kërkesat/ankesat e depozituara nga studentët rishikohen nga komisioni i vlerësimit. Përgjegjësi i departamentit për ankesat që nuk marrin zgjidhje vë në dijeni Dekanin e fakultetit. Pas marrjes dijeni për ankesën e studentëve, decani ngre një komision i cili kryen verifikimin përkatës të ankesës së studentit. Komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar dhe njofton studentin për vendimin e marrë nga dekani. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, dokumentohet dhe arshivohet në departament. <i>Dok. (Rregullore e UT-së, neni 50; 51; Rregullore e Njesisë Kryesore/FEUT).</i>								
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet									
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues (<i>Rregulloren e UT/FEUT si dhe Rregulloren e Programit të Studimit; Syllabuset e Lëndëve</i>) GVJ konstatoi se; kurrikula dhe plani mësimor i programit të studimeve Master i Shkencave në "Kontabilitet dhe Auditim" është ndërtuar dhe strukturuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, si dhe garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Në syllabuset e çdo lënde, studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat, aftësitë dhe njohuritë që do të marrin në modulin
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e	

<p>teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>përkatës. Disa nga objektivat e programit të studimit janë, përvetësimi i literaturës kryesore të fushës së studimit, thellimi, zgjerimi dhe specializimi i koncepteve për tu mundësuar studentëve zhvillimin e metejshëm të karrierës dhe vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë të doktoratës. Ky program studimi u ofron studentëve një system të gjerë njohurish në fushën e kontabilitetit, auditimit, standardeve ndërkombëtare e kombëtare të kontabilitetit, standardeve ndërkombëtare të auditimit, në fushën e kontabiliteti public dhe të organizatave jo fitimprurëse. Për realizimin e objektivave, programi i studimit synon thellimin e njohurive në fusha të tilla bazë si ato të kontabilitetit financiar, të kontabilitetit të drejtimit, administrimit fiskal dhe doganor, të analizës së pasyrave financiare, kontabiliteti ligjor, shërbimeve të sigurisë dhe konsulencës, metodave të kërkimit shkencor. Në lëndë të veçanta të programit, me karakter aplikativ si “Organizimi i sistemit të kontrollit kontabël”, Modelimi i spreadsheet ne Kontabilitet” studentët kanë mundësi të punojnë në sallat e laboratorëve me programe financiare, alpha web, bilanc, etj.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik, u konfirmua se në përputhje me rregulloren dhe objektivat e programit të studimit, studentët informohen në javën e parë të mësimin nga pedagogu përgjegjës i lëndës/modulit mbi programin e plotë të lëndës, objektivat, njohuritë dhe aftësitë që studenti pritet të fitojë gjatë zhvillimit të lëndës. Në javën e fundit të semestrit, pedagogu i lëndës bën një përmbledhje të njohurive dhe aftësive që janë arritur nga ana e studentëve lidhur me vlerësimin e vazhduar (seminareve, ushtrimeve, detyrave/projekteve të kursit, esseve, etj). Gjithashtu, pedagogu i orienton studentët në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku duhet të përqëndrohen, informon për strukturën, natyrën e pyetjeve dhe ushtrimeve që do të ketë provimi përfundimtar.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik, u konfirmua se në përputhje me rregulloren dhe objektivat e programit të studimit, studentët informohen në javën e parë të mësimin nga pedagogu përgjegjës i lëndës/modulit mbi programin e plotë të lëndës, objektivat, njohuritë dhe aftësitë që studenti pritet të fitojë gjatë zhvillimit të lëndës. Në javën e fundit të semestrit, pedagogu i lëndës bën një përmbledhje të njohurive dhe aftësive që janë arritur nga ana e studentëve lidhur me vlerësimin e vazhduar (seminareve, ushtrimeve, detyrave/projekteve të kursit, esseve, etj). Gjithashtu, pedagogu i orienton studentët në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku duhet të përqëndrohen, informon për strukturën, natyrën e pyetjeve dhe ushtrimeve që do të ketë provimi përfundimtar.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga takimi me stafin akademik, u konfirmua se personeli akademik i Departamentit të Kontabilitetit në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat publike brenda dhe jashtë vendit, si dhe bizneset më të</p>



<p>të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>suksesshme me të cilat institucioni ka marreveshje bashkëpunimi, organizon leksione të hapura me ekspertë të njohur të fushës së kontabilitetit dhe auditimit. Një praktikë tjetër e rëndësishme e ndjekur nga Departamenti janë edhe leksionet e hapura që zhvillohen nga lektorë të huaj, të ftuar në kuadër të programeve ERASMUS+ nga universitete perëndimore.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit_MSh; Lista e marreveshjeve të bashkepunimit; https://feut.edu.al/lajmerime/1381-leksion-i-hapur-ne-fe-me-teme-what-is-erp-why-do-we-need-erp).</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>Rregullorja e Programit të Studimit; Plani mësimor, Syllabuset e Lëndëve</i>), konstatoi se në hartimin e këtij programi studimi, departamenti, ka pasur në konsideratë, formimin e studentëve me objektiva të qartë për tu punësuar në tregun e punës. Departamenti së bashku me stafin akademik bën përpjekje të vazhdueshme për rishikimin e programeve të studimit dhe kurrikulave përkatëse, duke marrë në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve si dhe zhvillimet ekonomike në vend për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave dhe nevojave të tregut të punës për punësimin e studentëve. Programi i studimit Master i Shkencave në "Kontabilitet dhe Auditim" është orientuar në ofrimin e njohurive teorike dhe praktike në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KA; Plani Mesimor; Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara</p>	<p>Nga takimi i GVJ me stafin akademik, u konfirmua se personeli akademik i këtij departamenti nxit dhe motivon studentët që të zhvillojnë sa më shumë diskutime dhe të punojnë në grupe gjatë zhvillimit të procesit mësimor por edhe në projekte të ndryshme kërkimore. Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet dhe orienton studentët në grupe për realizimin e detyra/projekteve të kursit përmes simulimit dhe zgjidhjes së një problemi të caktuar. Gjithashtu pedagogët mbështesin dhe inkurajonë studentët të marrin pjesë në konkurse dhe aktivitete të ndryshme për të shpalosur idetë e tyre inovative.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit_MSh).</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Nga takimin e GVJ me dekanin e FEUT-së, u konfirmua se në funksion të menaxhimit dhe përmirësimit të burimeve dhe infrastrukturës së kërkimit shkencor, institucioni planifikon</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara</p>	<p>Ne takimin e GVJ me dekanin e FEUT-së, u konfirmua se në funksion të menaxhimit dhe përmirësimit të burimeve dhe infrastrukturës së kërkimit shkencor, institucioni planifikon</p>

<p>kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>mbështetjen financiare për kërkimin shkencor, organizimin e konferencave shkencorë duke përfshirë financimin edhe për studentët e ciklit të tretë të doktoraturës. Në takimet e realizuara me përfaqësuesit e Drejtorisë së Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, u konfirmua pjesëmarrja e studentëve të FEUT-së, në projekte kërkimore, konferenca shkencore, si dhe aktivitetete të tjera.</p> <p><i>Dok. (Plani strategjik i kerkimit shkencor të UT-së, 2018-2022; Veprimtaria e Zyrës Karrierës; Konferencat Shkencore).</i></p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues si dhe nga takimi i GVJ me përfaqësuesit e Drejtorisë së Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë të FEUT, u konfirmua se Njësia kryesore/FEUT dhe njësitë bazë janë të përfshira në disa projekte kërkimore si dhe kanë një sërë marrëveshje me IAL jashtë vendit në kuadër të programeve Erasmus +, të cilat kanë mundësuar mobilitetet për stafin akademik dhe studentët e këtij fakulteti. Gjithashtu stafi akademik i këtij departamenti nxit dhe motivon studentët që të punojnë në grupe gjatë zhvillimit të procesit mësimor por edhe të marrin pjesë në projekte të ndryshme kërkimore-shkencore.</p> <p><i>Dok. (Statuti i UT-së; Plani strategjik i kerkimit shkencor të UT-së, 2018-2022; Marrëveshjet e bashkëpunimit; Lista e marreveshjeve në kuadër të programeve Erasmus +; Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë pergjegjëse/ bazë 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022, Tabela 17; Dosja e projekteve; Raportet vjetore të analizës së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të Dep. Kontabilitetit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi III.8</p>	
<p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e</p>	<p>Në zbatim të rregullores së UT/FEUT si dhe Rregullores për diplomimin e UT-së, njësia bazë përcakton procedurat</p>

<p>diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>zhvillimin e provimit final ose mbrojtjen e diplomës. Detyrimi përmbyllës për programin e studimeve Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”, në përputhje me rregulloren e programit të studimit bëhet me punim diplome. Punimi i diplomës është një punim i pavarur shkencor i studentit. Departamenti informon studentët përmes standave të tij, faqes së internetit, apo edhe takime me studentët për kriteret që kërkohen të plotësohen për procedurat e punimit të diplomës. <i>Dok. (Rregullore e UT-së, neni 60; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore për diplomimin e UT-së_2022 Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA).</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Nga takimi me P/Departamentit dhe stafin akademik u konfirmua se në zbatim të rregulloreve përkatëse, departamenti ka ngritur një grup pune të përbërë nga personeli i tij akademik, me qëllim këshillimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve për përgatitjen e mikrotezës. Grupi i punës ka krijuar postën elektronike për të mundësuar komunikimin midis studentëve dhe pedagogëve udhëheqës. Kjo postë shërben si mënyrë komunikimi në vijimësi midis studentit dhe pedagogut udhëheqës, i cili mbikëqyr dhe udhëheq studentin në gjatë përgatitjes së mikrotezës. Gjithashtu FEUT ka përgatitur një udhëzues për përgatitjen e mikrotezës nga studentët për ciklin e studimeve MSh. Ky udhëzues përcakton të gjitha modalitetet e nevojshme për përgatitjen e mikrotezës (rregullat e shkrimit, rishikimit të literaturës, metodologjisë, rezultateve dhe diskutimeve, përpunimit të dhënave, tabelave dhe figurave, konkluzionet dhe rekomandimet, citimet, shkurtimet, referencat si dhe anekset përkatëse). <i>Dok. (Statuti i UT-së, neni 86; Rregullore e UT-së, neni 60; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Udhëzues për përgatitjen e mikrotezes/FEUT; Korrespondenca me studentet për përgatitjen e mikrotezës).</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në përputhje me rregulloren e UT/FEUT, Rregulloren për diplomimin në UT, si Rregulloren e programit të studimit, detyrimi përmbyllës për programin e studimeve Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” bëhet me punim diplome. Studentëve u vihet në dispozicion një listë me tema për punimin e diplomës të përgatitur nga stafi akademik në përputhje me fushat akademike dhe kërkimore të programit të</p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>studimit me qëllim orientimin për zgjedhjen e temës së mikrotezës. Nga ana e koordinatorit të programit të studimit MShKA, u jepet studentëve një formular, për të plotësuar fushën e studimit, si dhe propozimin për pedagogun udhëheqës. Mbi këtë bazë duke respektuar kërkesat e studentëve bëhet lidhja student-pedagog udhëheqës. Pas përzgjedhjes nga studenti të temës, pedagogut udhëheqës, Departamenti miraton listën përfundimtare me temat e diplomave, emrat e studentëve dhe pedagogëve udhëheqës. Kjo procedurë u konfirmua dhe në takimin e GVJ me stafin akademik dhe studentët.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e UT-së; Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit MSh_KA; Rregullore për diplomimin e UT-së_2022; Udhëzues për përgatitjen e mikrotezes/FEUT; Listat e temave të punimit të diplomës; Korrespondenca me studentet për përgatitjen e mikrotezës).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në zbatim të rregulloreve përkatëse, si dhe gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët u konfirmua se gjatë periudhës së përgatitjes së punimit të temës së diplomës, pedagogët udhëheqës planifikojnë një kalendar takimesh të shpallur për të ndihmuar dhe konsultuar studentin për realizimin e mikrotezës. Përmes platformës MS Teams si dhe postës elektronike, realizohet komunikimi midis studentëve dhe pedagogëve, në lidhje me mbarëvajtjen e punës për përgatitjen e mikrotezes. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Pedagogu udhëheqës përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë nga studentin për përgatitjen e mikrotezës sipas programit të miratuar. Pedagogu udhëheqës pranon, vlerëson dhe dorëzon në sekretarinë e departamentit formularin e vlerësimit të mikrotezës. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin nga pedagogu udhëheqës.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Pedagogu udhëheqës përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë nga studentin për përgatitjen e mikrotezës sipas programit të miratuar. Pedagogu udhëheqës pranon, vlerëson dhe dorëzon në sekretarinë e departamentit formularin e vlerësimit të mikrotezës. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin nga pedagogu udhëheqës.</p> <p><i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit të Studimit MSh_KA; Korrespondenca me studentet për përgatitjen e mikrotezës; Dosja e udhëheqjes së temave të diplomave).</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët dhe në përputhje me rregulloren e programit të studimit u konfirmua se para mbrojtjes së temës të diplomës, pedagogu udhëheqës</p>

<p>diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>rishikon dhe miraton punimin e mikrotezës së përgatitur nga studenti duke e firmosur atë. Studenti dorëzon kopjen e punimit të mikrotezës të miratuar nga pedagogu udhëheqës në kopje elektronike dhe hardcopy në Departament. Mbrojtja e diplomës behet përpara një komisioni që përbëhet nga 3 anëtarë, përbërja e të cilit miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Studenti në përfundim të mbrojtjes së diplomës vlerësohet me notë. <i>Dok. (Rregullore e Njesise Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Rregullore për diplomimin e UT-së_2022; Plani mësimor; VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga instucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021).</i></p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përputhje me kriteret dhe standardet e percaktura në rregulloren e UT-së, studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat sipas planit mësimor, ka shlyer dhe përbushur të gjitha detyrimet e programit të studimit, pajiset nga fakulteti me diplomën përkatëse. Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”. <i>Dok. (Statuti i UT-së; Rregullore e UT-së; Forma e diplomës dhe Suplementi i diplomës).</i></p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës (Rregullorja e UT/FEUT-së, Rregullorja e programit të studimit) GVJ, konstatoi se diploma për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”, shoqërohet me listën e notave si dhe suplementin e diplomës. Përmbajtja dhe forma e diplomës dhe suplementit të diplomës është e përcaktuar në Statutin e UT-së. Gjithashtu në përfundim të studimeve, studentëve sipas kërkesës së tyre i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e syllabuseve të lëndëve për programin e studimit që kanë kryer së bashku me suplementin e diplomës. <i>Dok. (Statuti i UT-së; Rregullore e UT-së; Rregullore e Njesisë Kryesore/FEUT; Rregullore e Programit te Studimit_MSh_KA; Suplementi i diplomës).</i></p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës dhe në zbatim të kriterëve dhe udhëzimeve të MAS, diploma për programin e studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim” regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin</p>

rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	shkencor, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore të MAS. Dokumentacioni për studentët, ruhet nga IAL për një periudhë të pacaktuar në hardcopy (Regjistri themeltar i studentit, Regjistri i arritjeve akademike të studentit dhe Regjistri i lëshimit të diplomave). Dokumentacioni në hard copy ruhet në ambjentet e sekretarisë mësimore të fakultetit. Universiteti disponon, informacione dhe të dhëna për studentët në përputhje me rregullat e përcaktuara. <i>Dok. (Statuti i UT-së; Rregullore e UT-së; Rregullore e Njesisë Kryesore/FEUT; Udhëzimet e MAS).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik,	Nga konsultimi me rregulloren e Institucionit, konsultimi me Formatin e Dosjes personale të Stafit Akademik, , sikurse dhe vizitën në zyrën e burimeve njerëzore pranë institucionit, GVJ konstaton se, nga përzgjedhja rastësore e dosjeve për anëtarët e stafit akademik, të dhënat për anëtarët e personelit akademik janë të plota dhe të përditësuara. Mbetet për t'u standartizuar formati i CV-ve, azhurnimi i tyre si dhe të ndahen pasi në portal ishin ngarkuar të gjitha CV e Stafit Akademik të fakultetit dhe jo vetëm të lektorëve përgjegjës për Programin e Studimit. <i>Dok. (Rregullore e Institucionit, Rregullore e Njesisë Kryesore/FEUT Formatit i Dosjes personale te Stafit Akademik, CV e stafit</i>

<p>si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p><i>akademik të programit të studimit dhe Stafit Ndimës Akademik të programit të studimit).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga konsultimi me formati i dosjes se stafit, statutin e institucionit, faqen web të IAL si edhe duke iu referuar bazës ligjore e nënligjore në fuqi, GVJ arriti në konkluzionin se percaktohen qarte procedurat per rekrutimin e personelit akademik në përputhje me bazen ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Referuar nenit 51 të Statutit të IAL, Përgjegjësi i Departamentit i bën propozimin Dekanatit për nevojat për rekrutimin e Stafit Akademik, Publikimi i shpalljes në vijim bëhet në fletoren zyrtare. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision i ngritur enkas, ku pjesë e tij është edhe përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Dok (Formati i dosjes së Stafit Akademik; Statuti i UT-së).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ referuar Statutit të UT, Rregullores së UT si dhe nga biseda me Përgjegjësin e Departamentit, drejtuesin e njësive bazë si dhe nga bisedat me zyrën e burimeve njerëzore arriti në konkluzionin se ekzistonte një praktikë e rregulluar për rekrutimin dhe procedurat që parashikojnë punësimin e personelit akademik, në përputhje kjo procedurë qoftë me nevojat e brendshme qoftë me planin strategjik të kërkimit shkencor. Përgjegjësi i Departamentit bën propozimin për personel akademik apo ndihmës akademik, te Dekani, i cili pasi verifikon dhe bie dakort përcjell miratimin në rektorat për ndjekjen e mëtejshme të procedurave për shpalljen e vendeve të lira të punës. Shpallja bëhet në Buletinin e Agjensisë së Prokurimit Publik si dhe në webfaqen e njësive Bazë, ku percaktohet qartë kriteret që duket të ketë kandidati. <i>Dok. (Statuti i UT, Rregullore e UT, Planit Strategjik për Zhvillimin e Njësive Bazë).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe</p>	<p>Referuar dokumentit përcjellje për miratim kriteresh për Stafin Akademik drejtar Dekanit nga ana e Përgjegjësit të Departamentit, nga intervistat me pedagogët që lëvrojnë kurrikulën e programit të aplikuar për akreditim, konsultimin me statutin e UT dhe konsultimin me dosjet e stafit akademik në zyrën e burimeve njerëzore, procedura e rekrutimit sa i përket specifikimeve të kriterëve dhe përputhjes me vendin e synuar të punës, është në përputhje me objektivat e institucionit dhe programin për të cilin kërkohet akreditim. Konkretisht, në</p>

përmbajtjen e programit të studimit	përputhje me nenin 59, pika 6 e Ligjit 80/2015, të gjithë pedagogët e angazhuar në programin e aplikuar për akreditim mbajnë gradë minimalisht të ciklit pasardhës kundrejt programit ku janë angazhuar në mësimdhënie. <i>Dok. (Dokumenti: Përcjellje e miratim kritere për personel akademik, Statuti i UT-së në nenet 67 mbi punësimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe nenit 68, për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Duke iu referuar vizitave të mjedisit fizike e virtuale të FEUT, takimit me stafin dhe drejtuesit, konstatohet se FEUT ka zyra për personelin akademik të secilit departament, zyra për sekretarinë mësimore, për financën për përgjegjësin e departamentit, për Koordinimin dhe Mbështetjen e Studentëve si dhe sallë konsultimesh. Ambientet në fjalë japin mundësitë për kryerjen profesionale të detyrave dhe janë në përputhje me bazën ligjore e nënligjore në fuqi (VKM 418, dt. 10.05.2017 dhe Udhëzimin nr. 1, dt. 14.01.2020). Të njëjtën gjë konfirmojnë edhe të dhënat e tabelave mbi strukturat akomoduese dhe laboratorët. <i>Dok. (Foto të mjedisëve të FEUT dhe Tabela me të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet).</i>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Referuar dokumenteve mbi vlerësimin e performances, vlerësimin e cilësisë, raportit vjetoror mbi veprimtaritë e kryera, Planit strategjik për Kërkimin shkencor të UT-së si dhe vendimit nr 29 datë 22.07.2021 rezulton se FEUT ka parashikur fonde për kërkimin shkencor, por është e pamundur të konkludohet nëse fondet janë disbursuar vazhdimisht (400 mijë lekë sipas buxhetit të 2021) janë shpërndarë stafit akademik për kualifikimit të vazhdueshëm që mbulon dhe administron programin e studimit. Konkretisht, dokumentat në fjalë japin informacion mbi mënyrën e vlerësimit dhe

	<p>raportet mbi veprimtarinë kërkimore shkencore. Që është relativisht e pasur. Nga ispektimi në terren në mjediset e fakultetit (biblioteka, akses online në artikuj, libra dhe softje aplikative) konstatohen investime të qenësishme për rritjen potenciale profesionale të personelit. <i>Dok. (vlerësimi i performancës, vlerësimi i cilësisë, raporti vjetëror mbi veprimtarinë e kryera, Planit strategjik për Kërkimin shkencor të UT-së, vendimi nr .29 datë 22.07.2021 për miratimin e Udhëzuesit "Për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor, buxheti i miratuar për vitin 2021).</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga dokumentet e depozituara në ASCAL, nuk konstatohet ekzistenca e programeve me këtë synim. Nga vizita në FEUT rezulton se FEUT ka bërë investime në teknologjinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, nisur dhe nga situata me pandeminë në të kaluarën. Gjë kjo që u konfirmua edhe nga bisedat me studentët dhe stafin. Në websitin e universitetit (https://feut.edu.al/lajmerime/1636-perfundon-trajnimi-i-48-pedagogeve-te-rinj-te-fakultetit-te-ekonomise) jepet informacion mbi trajnimin e stafit të ri akademik.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin mbi angazhimin e Stafit Akademik dhe ndihmës akademik, edhe nga takimi me pedagogë dhe drejtues të subjektit, rezulton se plotësohet detyrimi ligjor për raportin 70/30 në përqindje i pedagogëve të brendshëm kundrejt atyre të jashtëm (cilësuar në VKM nr. 418, dt. 10.05.2017, pika 2, gërma "b", niveli "ii". Pra kriteri përmbushet plotësisht. GVJ nga inspektimi në ambientet e FEUT vërejti se kishte një sërë zyrash mbështetëse që mundësonin përmbushjen me sukses të objektivave të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Referuar vizitave në terren si dhe dokumentacionit të ngarkuar në portalin e Ascal rezultoi se FEUT ka rreth mbi 40 salla lesionesh dhe seminaresh të ndara në dy godina, të ristrukturara plotësisht së fundmi, si dhe një sërë laboratorësh informatikë.</p> <p>GVJ arrin në konkluzionin se kriteri plotësohet në përputhje me kërkesat ligjore (VKM nr. 418, dt. 10.05.2017 dhe Udhëzimit nr. 1, dt. 14.01.2020 të titullarit të MASR). <i>Dok. (Foto të mjediseve të FEUT, Tabela me të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Referuar vizitës në terren dhe njohurive specifike të ekspertëve të jashtëm, kërkesat e këtij kriteri plotësohen në terma absolutë dhe relativë nga FEUT. Infrastruktura hard dhe soft e FEUT është bashkëkohore, e licensuar konform ligjeve dhe në përputhje me nivelin e njohurive të stafit akademik e ndihmës akademik. U konstatuan një numër i mjaftueshëm kompjuterësh, projektorësh, sisteme audio dhe routerash për lidhje në Internet. Interneti në Ethernet dh Wi-Fi ishte funksional. <i>Dok. (Foto të mjediseve të FEUT, Tabela me të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet.)</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga dokumentacioni i ngarkuar në platformën e ASCAL jepet manuali i Alpha Web, dhe nga inspektimi i laboratorëve të informatikës u konstatuan software që përdoren për kontabilitetin si Alpha dhe Financa 5, si dhe softwerë statistikorë si Eviews apo SPSS, të nevojshme këto për kryerjen me sukses të programit mësimor. Kompjuterët ishin të parametrave optimalë për nevojat e punës dhe mësimdhënies. <i>Dok. (Manuali Alpha web, Tabela me të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga vizita në ambiente të FEUT-së, në të dy Godinat (A dhe B) ku zhvillohet aktiviteti mësimor rezultoi se subjekti kishte laboratorë informatike të pajisur më së miri në këtë drejtim, për programet për të cilat ka aplikuar për akreditim.</p> <p><i>Dok. (Foto të mjediseve të FEUT, Tabela me të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet.)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron</p>	<p>Referuar dokumentacionit të ngarkuar në portalin e ASCAL rezultoi se institucioni ka një sërë marrveshjesh bashkëpunimi</p>

dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<p>qoftë për zhvillimin e praktikave profesionale për studentët e bachelor apo atyre të master qoftë për mundësinë e punësimit të studentëve mbas mbarimit të mastrerit.</p> <p>Nga bisedat me stafin akademik dhe studentët rezultoi se një pjesë e stafit akademik të jashtëm punonte në shoqata apo sipërmarrje private në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, ku u kishin mundësuar jo pak herë studentëve të kryenin praktikën profesionale apo të punësoheshin. <i>Dok. (Marrveshje bashkëpunimi me palët e treta, Marrveshje bashkëpunimi me ndërmjet UT, FEUT dhe IKM; Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit dhe për praktikën profesionale).</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Nga vizita në mjediset e FEUT konstatohet se FEUT disponon dhe vë në dispozicion të studentëve 1 bibliotekë mësimore brenda mjediseve të saj, sikurse edhe bibliotekën virtuale, me kredenciale personale të studentit për login. Po ashtu referuar dokumentacionit të ngarkuar në portalin e Ascal mbi informacionin e bibliotekës Joseph Limprecht rezultojnë se ka 200 vende të disponueshëm të ndara në 2 salla studimi.</p> <p><i>Dok. (Dokument informacioni për bibliotekën Joseph Limprecht, Manual Përdorimi U-library)</i></p>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e	<p>Nga vizita në mjediset e FEUT, konstatohet se kërkesat e këtij kriteri për tipet e ndryshme të literaturës fizike përmbushen plotësisht. Referuar të dhënave për bibliotekën rezultojnë se ka mbi 5200 tituj librash apo revistash në gjuhën shqipe apo të huaj, po ashtu Referuar buxheteve të miratuar të vitit 2019,</p>

përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	2020 dhe 2021 rezulton se FEUT ka një buxhet rreth 6 mln lekë për blerje librash. <i>Dok. (Buxheti i miratuar për vitin 2019, 2020, 2021).</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Subjekti, sikurse është cituar vazhdimisht më lart, disponon dhe ofron akses online për studentët e tij në biblioteka virtuale sic është Ulibrary apo Jstore, për të cilat paguan vetë, duke ua ofruar pa pagesë studentëve të programit të studimit. Po ashtu referuar buxhetit të miratuar për vitet 2019-2021 ka një zë në buxhet për abonime revistash elektronike apo libra elektronik por që nuk rezulton të jetë harxhuar ndonjë shumë e caktuar parash. <i>Dok. (Buxheti i miratuar për vitin 2019, 2020, 2021).</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Referuar dokumentit, infomacion për Bibliotekën “Joseph Limprecht rezuton se bibloteka disponon 200 vende studimi, 30 kompiutera të cilët janë në shërbim të studentëve për kërkimin e literaturës qoftë për tu përdorur përgjatë studimit qoftë për të realizuar temat e diplomës. Bibloteka dixhitale JSTOR u mundëson mbi 12 milionë artikuj të ndryshëm të ndarë në 75 disiplina. <i>Dok. (Informacion për Bibliotekën “Joseph Limprecht”).</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Referuar Buxheteve të miratuar në 3 vitet e fundit rezulton se ka zëra të caktuar për bibliotekën elektronike apo për abonime në revista të ndryshme. Referuar buxhetit të miratuar për 2021 rezulton se ka një zë që shkon për shtimin e fondit të librave. <i>Dok. (Buxheti i miratuar për vitin 2019, 2020, 2021; Buxheti i miratuar për 2021).</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Nga intervistat me stafin akademik dhe administrativ, mësimi në FEUT zhvillohet pasdite në Masterin Shkencor për të cilin është kërkuar akreditimi. Bibloteka apo sallat e shumta të leksioneve u mundësojnë studentëve studimin në orare të ndryshme. Bibloteka qëndron hapur deri në orën 19:30. Nga këto fakte GVJ krijoi bindjen e arsyeshme se biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi të përshtatshme, në përputhje me nevojat dhe numrin e studentëve. Njëkohësisht, për shkak të disponimit të bibliotekës online, oraret e aksesimit të informacionit nga studentët janë fleksibël dhe çlirojnë kapacitetet për përdorimin

	optimal të mjedisit fizik të bibliotekës. <i>Dok. (Informacion për Bibliotekën "Joseph Limprecht".)</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Për vlerësimin e këtij kriteri, ekspertët nuk patën të mundur të gjenin dokumentacion të karikuar në portalin e ASCAL, referuar faqes online dhe vizitën në sekretarinë mësimore, rezulton se dokumentacioni mbi regjistrimet dhe diplomimet mbahej kryesisht në version hard copy. Përditësimi i informacioneve bëhej manualisht dhe kish vonesa të mëdha me përditësimin elektronik. Portali i studentit nuk ishte funksional.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Nga vizita në drejtorinë e burimeve njerëzore brenda institucionit konstatohet se zyra e BNJ mban një dokumentacion të plotë të stafit akademik dhe jo akademik, sikurse edhe pedagogëve të ftuar për realizimin e programit. Ky dokumentacion ruhet manualisht dhe elektronikisht, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Referuar dokumentacionit të ngarkuar nga FEUT në portalin e Ascal rezultojnë një sërë tabelash për personelin akademik dhe ndihmës akademik për ngarkesën e plotë mësimore të Stafit akademik. <i>Dok. (Të dhënat tabelore për personelin akademik në programin e studimit për të gjitha vitet).</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Referuar sistemit e-student, manual përdorimi, rezulton se sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për: -studentë -pedagogët -sekretarinë mësimore

	<p>-IT</p> <p>-dekanin dhe zv.dekanin për procesin mësimor.</p> <p><i>Dok. (sistemi e-student, manual përdorimi)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga vizita në FEUT, meqënëse dokumentet e ngarkuara në ASCAL dhe ato të publikuara në faqen online të subjektit nuk ishin të disponueshme, ekspertët konstatuan prezencën e platformave virtuale të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit siç ishte platforma Teams. E konfirmuar kjo edhe nga studentët. Platforma në fjalë ishte përdorur si për zhvillimin e leksioneve virtuale përgjatë pandemisë, po ashtu edhe për komunikimin në distancë ndërmjet stafit akademik dhe studentëve, për të diskutuar mbi mbarëvajtjen e punimit final të temës së diplomës, apo për paqartësi të ndryshme që mund të kishin studentët.</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentat e ngarkuara në portalin e Ascal, konstatohet se njësia e garantimit të cilësisë ka përcaktuar procedura për të monitoruar në kohë reale dhe vazhdimisht aktivitetin akademik.</p> <p><i>Nga dokumentet e ngarkuara në aneksin e mësipërm apo anekse të tjera nuk mund të nxirret një përfundim i saktë për frekuencën e kontroleve dhe raportimeve, por nga bisedat me stafin akademik dhe studentët pohohet se ky proces është optimal. Sa i përket aspektit administrativ, institucioni ka instaluar kamera dhe sisteme sigurie për të garantuar dhe raportuar në kohë mbi sigurinë dhe kujdesin e shërbimeve të ofruara. Dok. (Rregullore e NJSBC).</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Nga inspektimi i prezencës online të këtij institucioni në faqen e tij zyrtare në https://feut.edu.al/, konstatohet se ky kriter përmbushet plotësisht në gjuhën shqipe.</p> <p><i>Mungon publikimi në gjuhën angleze ndërkohë që FEUT ka dhe studentë erasmus.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar dokumenteve të depozituar në ASCAL konstatohet se është hartuar një parashikim për kostot në tërësi të departamentit për mbështetjen financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit. Por që kjo shkresë mban datën 02/03/2022. referuar anekseve mbi buxhetet ndër vite rezulton se ka një parashikim të ardhurash nga degët e ciklit të parë dhe të dytë si dhe trasfertat qeveritare për mbështetjen financiare të FEUT. <i>Dok. (Përcjellje e shpenzimeve të buxheuara për vitin 2022).</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Referuar dokumentit mbi përcjelljen e shpenzimeve të buxhetuara për vitin 2022 rezulton se ka një plan të shpenzimeve e hartuar kjo në datën 02/03/2022, që është i dedikuar parashikimit të shpenzimeve për programin e studimit për të cilin është aplikuar për akreditim. Burimet e financimit të UT në tërësi apo FEUT-së në veçanti janë të përcaktuara nga neni 144 i statutit të UT-së, ku burimi kryesor i financimit është buxheti i shtetit, pagesat e studentëve për arsimimin si dhe grantet e huaja apo të ardhurat nga projektet. <i>Dok. (Përcjellja e shpenzimeve të buxhetuara për vitin 202, Statuti i UT).</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe	Referuar rregullores së UT, konkretisht, strukturës organizuese, rezulton se ka një Drejtor të Auditit të brendshëm që është përgjegjës për auditimin e brendshëm.

<p>efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Në dokumentacionin e depozituar në ASCAL nuk rezulton ndonjë raport auditi.</p> <p>Dok. (Rregullore e Universitetit të Tiranës).</p>
---	---

<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Sikurse më lart, nuk disponohet asnjë informacion mbi bazën e të cilit të konkludohet ky kriter. I vetmi dokument i ngarkuar në Ascal rezulton një përcjellje informacioni mbi planifikimin e të Ardhurave dhe Shpenzimeve për vitin 2022, të Departamentit të Kontabilitetit. Dokumenti mbi buxhetin faktik të 2020 dhe parashikimit për 2021 nuk jep informacion mbi plotësimin e këtij kriteri.</p> <p>Dok. (përcjellje informacioni mbi planifikimin e të ardhurave për vitin 2022, Buxheti 2020).</p>
--	---

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Referuar raporteve buxhetore, Institucioni dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme, para këto që vijnë kryesisht nga grantet dhe trasfertat qeveritare. Dok. (Buxheti i miratuar për 2021, Buxheti i miratuar për 2019, 2020, 2021).</p>
---	---


Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Referuar Statuti dhe Rregullores të UT-së dhe faqen online të subjektit, https://feut.edu.al/, konstatohet se janë hartuar politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve.</p> <p>Gjurmët e zbatimit të këtyre politikave konfirmohen nga vizita në sekretarinë mësimore, ku mund të shihet qartë procedurat e rregjistrimit, dhe dokumentacionit që ato mbanin, sikurse edhe biseda me kampionin e studentëve e konfirmonte këtë gjë. FEUT ka përcaktuar qartë kriteret e pranimit apo kuotat e propozuara, dhe promovon vazhdimisht këto kritere të ëbfaqja e saj. <i>Dok. (Statuti i UT, https://feut.edu.al/lajmerime/766-1-mbi-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-ne-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-ne-fakultetin-e-ekonomise-ut-per-vitin-akademik-2022-2023).</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentet e cituar më lart, konstatohet se vlerësimi në aplikim, pranimi, mësimdhënia dhe diplomimi i studentëve në programin e aplikuar për akreditim kryhet mbi parimet e mosdiskriminit mbi çdo lloj karakteristike individuale, barazisë dhe të drejtave universale. Kriteri për pranim dhe diplomim i referohet meritës në arritjet universitare të ciklit paraardhës (pranim) dhe kryerjes së studimeve (diplomim). <i>Dok. (Statuti i UT, neni 7, Rregullore e programit të ciklit të dytë, Master Shkencor në KA, https://feut.edu.al/lajmerime/766-1-mbi-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-ne-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-ne-fakultetin-e-ekonomise-ut-per-vitin-akademik-2022-2023).</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të</p>	<p>Referuar dokumenteve të sipërcituara, si edhe syllabuseve (vlerësimi i dijeve të nxëna), ecurinë e diplomimeve apo mobilitetet krijohet bindja e arsyeshme se kriteret për këtë rubrikë janë lehtësisht të kuptueshme dhe aksesueshme nga publiku. Në hartimin e RVB-së, grupi i ekspertëve të brendshëm i është referuar edhe prezencës në web faqen në seksionin e lajmërimeve për aksesimin e informacionit nga të interesuarit. Nga kontrolli në faqe konstatohet se informacioni</p>

dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	i ngarkuar është i plotë, i përditësuar dhe lehtësisht i kuptueshëm e i aksesueshëm. <i>Dok. (Syllabuset e ofruara ndër vite, të dhëna të plota për rregjistrimin, ecurinë, diplomimin sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje; Të dhëna tabelore përmbledhëse për transferimin e studentëve; https://feut.edu.al/lajmerime)</i>			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Nga dokumentet e depozituara në ASCAL konstatohet se nuk përmbahen materiale që dokumentojnë kërkesat e këtij kriteri. Në bazë të Ligjit 80/2015, Udhëzimeve të përvitshme të ministrit përgjegjës për arsimin, si edhe statutit institucional kriteret hartohen dhe propozohen nga njësitë bazë, miratohen nga Senati dhe i përcillen MASR-së dhe QSHA-së. Nga konsultimi në faqen e FEUT-së, konstatohet se publikohen kriteret për pranimin në ciklin e dytë të studimeve. <i>Dok. (https://feut.edu.al/lajmerime)</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Nga konsultimi me dokumentacionin mbi politika e marketingut, konstatohet se institucioni bën marketing të produkteve të tij lidhur me këto programe studimi, duke udhëzuar publikun. Marketingu zhvillohet si me anë të të median vizive apo të shkruar si me anë të takimeve informuese me matuarantët, po ashtu edhe në rrjetet sociale. Në fillim të vitit akademik të interesuarit e kanë lehtësisht të aksesueshëm informacionin të faqja web e FEUT. <i>Dok. (Politikat e marketingut të programit të studimit, format e tij, trasparenca me publikun; Politikat institucionale të publikimit të informacionit).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në	Nga konsultimi me syllabuset e lëndës, konstatohet se në rubrikën e vlerësimit të dijeve përmbahen të plota procedurat për vlerësimin.

<p>lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Po ashtu nga biseda me studentët rezultoi se informacioni për përparimin akademik është lehtësisht i aksesueshëm për ta nga profesorët si dhe nga zyrat e sekretarisë si dhe publikohen në portalin U student. <i>Dok. (Syllabuset e ofruara ndër vite, Manual U student përdorimi).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Referuar statutit dhe informacionit rreth qëndrës së karrierës informacioni në lidhje me kërkesat e këtij kriteri plotësohet tërësisht nga institucioni. Takimet me studentët e konfirmuan një fakt të tillë. <i>Dok. (Statuti i UT, nenet 108-112, https://feut.edu.al/studentet/qendra-e-karrieres/85-rreth-qendres)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Ndonëse ky kriter është vetëm riformulim i kriterit 1 të po këtij standardi, përsërisim se nga konsultimi me syllabuset e ofruara ndër vite, si edhe takimi me pedagogë e studentë, konstatohet se studentët kanë plotësisht mundësinë të informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të tyre.</p> <p>Informacioni është i publikuar dhe lehtësisht i aksesueshëm për këtë qëllim. <i>Dok. (Syllabuset e ofruara ndër vite).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Nga konsultimi me statutin dhe me faqen online si dhe me dokumentin mbi modelin e diplomës dhe suplementit të diplomës si dhe takimet me pedagogë e studentë, konfirmohet përmbushja e kërkesave për informim të këtij kriteri nga ana e FEUT.</p> <p>Më konkretisht studenti për të realizuar me sukses temën e diplomës informohet që në fillimin e vitit të dytë kalendarik, atij i vihet në dispozicion një listë orientuese me tema të sugjeruara. Studentëve u vihet në dispozicion një udhëzues i punimit të diplomës. Po ashtu marrin informacion mbi profesorët e mundshëm për udhëheqës teme. <i>Dok. (Rregullore e programit të studimit, Modeli i diplomës dhe suplementit të diplomës; Tema të sugjeruara për Mikrotezën).</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të</p>	<p>Nga konsultimi me prezencën online të UT-së (faqe zyrtare) konstatohet se institucioni në mënyrë sistematike dhe rigoroz organizon takime fizike dhe virtuale me të interesuar për studentët të ardhshëm, sikur harton broshura udhëzuese për kriteret, kushtet dhe avantazhet e regjistrimit në këtë IAL. <i>Dok. (https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maturante-ne-universitetin-e-tiranes/).</i></p>

ardhshëm mbi programin e studimit				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Nga konsultimi i faqes së internetit dhe referuar nenit 85 të statutit të institucionit rezulton se institucioni duhet të publikojë në faqen web gjithë informacionin mbi strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimit etj. Gjithashtu në orën e parë të fillimit të këtij programi studimor studentët informohen nga stafi akademik mbi funksionimin e këtij programi studimi. Pra studentët kanë mundësinë të informohen hollësisht për detajet e programit të studimit të përzgjedhur, qoftë në mënyrë independentë duke vizituar faqen online qoftë duke komunikuar me sekretarinë apo stafin akademik. Nga takimi me studentët konfirmohet një informim i tillë paraprak. <i>Dok. (Statuti i UT-së, https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/34-kontabilitet-dhe-auditim).</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nga konsultimi me faqen online të FEUT si dhe syllabuset, konstatohet se kurríkula dhe plani mësimor përmbajnë në detaje informacionin për veprimtaritë akademike, praktike e profesionale të parashikuara. Më konkretisht gjenden informacione mbi modulet që do zhvillohen përgjatë këtij programi masteri shkencor së bashku me kreditet formative, semestrat kur do zhvillohen modulet, pesha e praktikës profesionale në kredite si dhe e mikrotezës etj. Në Syllabuset e lëndëve gjenden informacione të detajuara, mbi qëllimet, objektivat, temat që do të zhvillohen në një modul të caktuar, literatura e detyrueshme apo e sugjeruar si dhe forma e vlerësimit. <i>Dok. (Syllabuset e ofruara ndër vite,</i>

	https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/34-kontabilitet-dhe-auditim,).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Referuar dokumentacionit mbi punësimin real të studentëve dhe nga takimi me zyrën e karrierës, konstatohet se informacioni për kërkesat e këtij kriteri është pjesërisht i disponueshëm. Nga dokumentacioni mbi punësimin real të studentëve është e pamundur të merret informacion mbi punësimin e studentëve mbas diplomimit. Nga takimi me studentët konfirmohet informimi sipas kërkesave të të interesuarve. Përmes Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës, studentëve iu jepet informacion mbi mundësitë e punësimit. Po ashtu publikohen një sërë njoftimesh në web faqen e universitetit për mundësi punësimi sipas programit të studimit. <i>Dok. (Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve).</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nga takimet me studentët konfirmohet vënia në dispozicion e këtij informacioni në rrugë fizike dhe elektronike. Para fillimit të çdo semestri akademik, institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të detajuar mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nga takimi me stafin dhe studentët, u konstatua se, edhe për shkak të pandemisë, informacioni ishte lehtësisht i disponueshëm edhe në distancë qoftë falë faqes online të FEUT, sikurse i gjurmueshëm nga të gjitha strukturat menaxheriale të përfshira (pedagogët për mësimdhënien, NjSBC për kontrollin dhe sekretaria e administrata për regjistrimin dhe raportimin). Përdorimi i platformës Teams përgjatë pandemisë, siguronte informacion të mjaftueshëm edhe për respektimin e orareve apo trasmetimin e informacioneve të nevojshme për mësimdhënien dhe mësimnxënien.
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Nga bisedat me sekretarinë mësimore të FEUT-së, apo nga bisedat me studentët për përdorimin e sistemit Ms Teams për zhvillimin e leksioneve dhe komunikimin me pedagogët në distancëm, konstatohet përmbushja e kërkesave të këtij kriteri.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Institucioni dhe njësitë përgjegjëse mbajnë statistika vjetore mbi numrin e studentëve aktualë dhe të diplomuar në programin e studimit. Nga vizita në sekretarinë mësimore, të dhënat për studentët që vijonin ndjekjen e programit të studimit, ishin të plota dhe të mbajtura me kujdes, si nga pikëpamja sasiore, ashtu edhe ajo cilësore. <i>Dok. (Të dhëna të plota për rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve sipas viteve; të dhëna tabelore përmbledhëse për transferimin e studentëve; Të dhëna tabelore për punësimin real të studentëve).</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Nga takimi me sekretarinë mësimore, sikurse referuar të dhënave tabelore për vemprimtaritë e kryera (tabela 7) rezulton se, FEUT mban statistika të sakta dhe të plota në përmbushje të kërkesave të këtij kriteri. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është: Viti akademik 2019-2020 71 studentë; Viti akademik 2020-2021 85 studentë; Viti akademik 2021-2022 103 studentë; <i>Dok. (Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera 2018-2021).</i>
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Nga vizita në sekretarinë mësimore, inspektimi rastësor i regjistrit të studentëve, konstatohet se të dhënat për ecurinë akademike regjistrohen dhe ruhen korrektësisht. Këto të dhëna përputheshin me ecurinë e përmbajtur në procesverbal. Po ashtu u vu re se kishte një mungesë të mbajtjes së të dhënave në regjistrat e duhur dhe të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në vitin 2019.

<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga vizita në sekretarinë mësimore dhe inspektimi me zgjedhje rastësore i procesverbaleve dhe e hedhjes së të dhënave në rregjistra, konstatohet ruajtja e procesverbaleve si në versionin hard copy si në versionin elektronik, aksesimi i tyre sipas hierarkisë dhe funksionit të personit të interesuar, si edhe siguria e tyre përmes platformave mbrojtëse.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Referuar tabelës 7 pika katër në faqen 37 dhe 39, dhe të tabelave përmbledhëse të raportit mbi veprimtaritë e kryera në periudhën 2018-2021, sikurse edhe analiza e të dhënave mbi punësimin real të studentëve konstatohet hartimi i analizave në hyrje dhe në dalje të studentëve <i>por nuk konstatohet raportimi mbi punësimin e studentëve dhe përpjekjet për përmirësimin e treguesve të performancës.</i> Ka vetëm një pyetësorë të ngarkuar në Ascal që mban datën 09/06/2022. Sugjerohet që FEUT të hartojë raporte analitike për punësimin e studentëve të diplomuar dhe cilësinë e punësimit të tyre. Këto raporte do të shërbejnë në vijim për të përmirësuar kurrikulën apo forcimin e zyrës së Job Placement.</p> <p><i>Dok. (Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera 2018-2021; Analiza e të dhënave mbi punësimin real të studentëve; Studimi Periodik për tregun e punës pas daljes së studentëve).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e</p>	<p>Ligji i arsimit të lartë e lë në tagër të vetë IAL-së modalitetin e angazhimit të studentëve në zgjedhjet dhe pjesëmarrjen e tyre në strukturat drejtuese të institucionit ku studiojnë. Nga statuti i UT në nenin 30, pika 3, cilësohet se studentët përfaqësohen në senat me të zgjedhurin e tyre.</p>

<p>këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Në nenin 40 të statutit flitet për komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrdhëniet me studentët i cili ka 7 anëtarë, 4 personel akademik dhe 3 studentë. Po ashtu në nenin 41 të statutit flitet për Komisionin e Përhershëm për sigurimin e standarteve të cilësisë ku nga 13 anëtarë 2 janë studentë. Në nenin 42 gjejmë komisionin e përhershëm të kurrikulës ku edhe këtu kemi një anëtar studentë nga 13 anëtar. Në nenin 43 ku flitet për këshillimin e etikës përsëri gjejmë në përbërjen e tij 2 anëtarë studentë nga 9 anëtar që ka Këshilli i etikës. <i>Dok. (Statuti i UT).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Sa cituar më lart, studentët përfshihen në komisione të ndryshme (komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrdhëniet me studentët, nga 7 anëtarë, katër prej tyre janë student). Në hartimin e raportit të GVB kishte një student. Studentët po ashtu nga stafi akademik u vu në pah se studentët japin vlerësime për stafin pedagogjik dhe për kurrikulën. Pra ata marrin pjesë në vlerësimin e mësimdhënies me anë të pyetësorëve.</p> <p><i>Dok. (Pyetësori i studentëve, Statuti i UT).</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Nga konsultimi i statutit (neni 108 e 109) mbi ndjekjen e një programi të dytë studimi apo transferimet, si edhe intervistat me stafin pedagogjik dhe drejtuesit e institucionit, ngarkesa e parashikuar mësimore për studentët është 60 kredite në një vit akademik. Edhe studentët e konfirmuan një fakt të tillë. Po kështu, duke iu referuar dokumentit që trajton transferimet e studentëve dhe ekuivalentimin e dijeve të tyre, konstatohet se procedurat për transferim janë joburokratike dhe të mirëpritura. <i>Dok. (Statuti i UT-së, Të dhëna tabelore përmbledhëse për transferimin e studentëve).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton</p>	<p>Nga konsultimi i statutit, sikurse bisedat me pedagogët që zhvillojnë lëndët, krijohet bindja e arsyeshme se hartimi, implementimi dhe përmirësimi i programeve të studimit është një thellim i njohurive të marra në bachelor më tepër sesa produkt i bashkëpunimit me studentët. <i>Dok. (Statuti i UT-së).</i></p>

sugjerimet e kontributin e tyre në to.									
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	Nga bisedat me studentët konfirmohet edhe që studenti gëzon të drejtën e shprehjes së mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të provimit. Çdo student ka të drejtën e ankimimit të rezultatit të provimit, rishikimit të tezës dhe reflektimit nga ana e njësisë dhe pedagogut përgjegjës. Pra ekziston në praktikë anketimi dhe <i>feedback</i> -u, kjo u konfirmua nga bisedat me studentët dhe stafin akademik.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Plotësisht</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6	
Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Referuar raportit vjetor për veprimtaritë e kryera të FEUT, rezulton se ka 5 referime në konferenca shkencore ndërkombëtare, 3 botime jashtë vendit, 5 botime me impakt faktor, 2 projekte ndërkombëtare e dy botime librash. Referuar dokumentacionit të stafit akademik dhe dokumentacionit mbi organizimin e konferencave (3 të tilla), rezulton se personeli akademik merr pjesë në konferenca, organizojnë konferenca si dhe merren me kërkim shkencor. Edhe pse ndoshta numrat janë shumë të ulët nëse do të marrim në konsideratë që Departamenti ka mbi 20 pedagog me kohë të plotë. <i>Dok. Raporti vjetor mbi veprimtaritë e kryera nga FEUT 2018-2021; Cv e stafit akademik të personelit akademik me kohë të plotë; Konferenca ndërkombëtare; Konferenca të zhvilluara ndër vite).</i>
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me	Referuar aneksit mbi marveshjet mobilitetet e studentëve rezulton se përgjatë vitit akademik 2021-2022 rreth 60 studentë shqiptar u

<p>institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>është mundësuar të shkojnë në mbi 20 universitete të huaja, po ashtu ka pasur mbi 20 studentë të huaj që kanë zgjedhur të zhvillojnë një semestër në Tiranë. UT ka një sërë marrveshjesh të huaja me qëllim shkëmbimet studentore (35), kjo verifikohet më së miri nga numri i madh i universiteteve që kanë shkuar studentët e FEUT.</p> <p><i>Dok. (Mobilitetet e studentëve të FEUT për periudhën 2019-2020; Raporti vjetor mbi aktivitetet e kryera, tab.4.4).</i></p>		
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Referuar bisedave të bëra me studentët, referuar po raportit vjetor mbi veprimtarinë e kryera nga FEUT në periudhën 2018-2019 rezultoi se Institucioni u mundëson studentëve të marrin pjesë në aktivitete kërkimore shkencore (1 prej studentëve ka marrë pjesë me një punim në një konferencë ndërkombëtare). Po ashtu nga studentët rezultoi se një prej tyre ishte angazhuar edhe në procesin e mësimdhënies në një IAL publik tjetër.</p> <p><i>Dok. (Raporti vjetor mbi aktivitetet e kryera).</i></p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Referuar dokumentit mbi buxhetin e miratuar në faqen 8 ekziston një zë në buxhet 20 mln lekë për shpenzime për kërkimin shkencor, honorare aktivitete të bordit të administrimit, senati, komisione ad hoc etj. Shpenzime për tatime, taksa apo tarifa shpenzimesh. Nga materialet e tjera të ngarkuara në ASCAL është e vështirë të arrihet në një konkluzion mbi këtë kriter. <i>Dok. (Dokument përcjellje e shpenzimeve të buxhetuara për vitin 2022, Departamenti i Kontabilitetit).</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Nga bisedat me grupin e studentëve rezultoi se në faqen e internetit të FEUT publikohen herë pas herë lajmërimi pune, apo ishte organizuar panairi i karrierës. Në dokumentat e ngarkuara në ASCAL nuk mund të nxirret në pah verifikimi i plotësisht të kriterit në fjalë.</p>		
<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>Nga bisedat me studentët dhe stafin pedagogjik rezultoi se personeli akademik është gjithmonë i gatshëm të bashkëpunojë dhe mbështesë studentët në realizimin e punimit final të diplomës.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi V.7

Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Referuar strategjisë së të zhvillimit të institucionit dhe planit strategjik për zhvillimit të institucionit dhe njësisë bazë rezulton UT-ja ka ndjekur një politikë bashkëpunimi me Universitete të huaja qoftë në aspektin e mobilitetit të stafit qoftë atë të studentëve. Po ashtu referuar listët së studentëve që kanë zhvilluar programe Erasmus jashtë (60 për vitin akademik 2021-2022 nga të cilët 12 nga dhe drejt programit të studimit Master Shkencor KA GVJ afirmon se ky kriter plotësohet.</p> <p><i>Dok. (Strategjia e zhvillimit të Institucionit, Plani Strategjik për zhvillimin e programit-Njësia bazë; Mobilitetet e studentëve të FEUT për periudhën 2019-2020).</i></p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Referuar listës së syllabuseve rezuton se ka lëndë siç është ajo e “Metodologjia e kërkimit dhe metodat sasiore ne kontabilitet” që u mundëson studentëve të marrin njohuri dhe aftësi të metodave bazë të kërkimit shkencor. Studentëve u garantohet përgatitja për fillimin e ciklit të tretë studimor.</p> <p><i>Dok. (Syllabuset e lëndëve të ofruara ndër vite).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Bisedat me grupin e studentëve nuk e konfirmojnë plotësimin e këtij kriteri. Në dokumentacionin e ngarkuar në ASCAL nuk rezulton ndonjë dokumentacion që të konfirmojë plotësimin e këtij kriteri.</p>
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Marrveshjet për programet e mobilitetit të studentëve dhe stafit pedagogjik mundëson më së miri bashkëpunimin me kërkuesit shkencorë të huaj, kjo pasi një ndër funksionet e mobilitetit të stafit akademik është pikërisht krijimi i netëorkeve për të punuar në projekte kërkimore shkencore. Vendosija po ashtu e marrdhënieve të bashkëpunimit u mundëson IAL-ve Shqiptare, në rastin konkret UT-së të valutohet si partner lokal për projektet e financuara nga BE. Po ashtu në ëebfaqen e FEUT ka lajmërimet mbi orë të hapura</p>

	me staf të huaj. Dok. (https://feut.edu.al/lajmerime/1381-leksion-i-hapur-ne-fe-me-teme-ehat-is-erp-ehy-do-ee-need-erp)			
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Referuar bisedave me studentët GVJ arriti në konkluzionin se në sajë të suportit që jep zyra e karrierës ata marrin informacion mbi bursat dhe mundësitë e mobiliteteve. Po ashtu ata marrin asistencë të vazhdueshme për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.			
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Referuar dokumentacionit të ngarkuar në ASCAL si dhe referuar raportit të GVB (japin një aktivitet të para 5 viteve të një departamenti tjetër). GVJ nuk është në gjendje të afirmojë plotësimin e këtij kriteri. Thënë kjo, në faqen online të FEUT ka në fakt edhe lajmërimet të tjera për leksione të hapura si dhe një sërë konferencash organizohen me partner të huaj. Dok. (https://feut.edu.al/lajmerime/1381-leksion-i-hapur-ne-fe-me-teme-ehat-is-erp-ehy-do-ee-need-erp ; Konferenca të zhvilluara ndër vite.)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Nga vizita në terren në zyrën e karrierës, zyrën e informacionit dhe sekretarisë mësimore si dhe nga biseda me studentët rezulton se këta të fundit kanë një sërë alternativash për marrjen e informacionit qoftë duke komunikuar me zyrën e informacionit apo sekretarinë mësimore, qoftë duke vizituar faqen e FEUT, për data e provimeve apo kalendarin akademik. Dok. (https://ëëë.feut.edu.al/orari-mesimor-data-provimesh-feut-links).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për	Referuar bisedave me studentët, nga inspektimi në terren te sekretaria mësimore si dhe nga ëëb faqja e FEUT rezulton se, kjo e fundit u mundëson studentëve zyrën e karrierës që u jep

informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	studentëve mbështetje si për realizimin e procesit mësimor po ashtu edhe për mundësitë e punësimit. Sekretaria mësimore po ashtu është në dispozicion të studentëve për informacione të ndryshme në lidhje me procesin mësimor apo dokumentacione të caktuara.			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Referuar bisedave me studentët, nga vizita në terren te zyra e këshillit të karrierës, bisedat me stafin pedagogjik si dhe nga ëeb faqja e FEUT rezulton se ky kriter plotësohet. Bashkëpunimi i stafit pedagogjik me institucione të ndryshme publike dhe private u kishte mundësuar studentëve qoftë orientimin e mirë për praktikat profesionale qoftë mundësimin e gjetjes së një vendi pune. Studentët informuan GVJ se shumica e tyre kishin tashmë një vend pune. Ata afirmuan se mbështetjen kryesore për gjetjen e vendit të punës e kishin marr nga stafi akademik. Qendra e karrierës u çonte atyre informacione të herëpashershme me email, por që ata e konsideronin jo shumë efektive zyrën e këshillimit të karrierës.			
Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Nga bisedat me sekretarinë stafin përgjegjës në zyrën e karrierës si dhe referuar dokumentit mbi të dhënat tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve. GVJ nuk është në gjendje të japi një vlerësim për plotësimin e këtij kriteri. <i>Dok. (Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
---	------------	-----------------------	----------------------	-----------------------------------

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënljgore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në përputhje me Ligjin 80/2015 (neni 103), VKM nr. 531, dt. 11.09.2018 (Kodi i Cilësisë), statutin institucional si edhe duke iu referuar aneksit 8.3 dhe 8.4 (vendimi për miratimin e NjSBC si dhe plani i veprimtarisë) konstatohet se është ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe janë parashikuar rregullat e procedurat për funksionimin e saj. Në planin strategjik institucional gjenden politika të përgjithshme lidhur me cilësinë. <i>Dok. (Statuti i UT; Plani i veprimtarisë NJSBC; Vendimi nr. 11, datë 28.09.2021 për miratimin e NJSBC).</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Referuar dokumentacionit që referohen manualit të cilësisë në UT dhe FEUT si dhe NjSBC-së konstatohen metodologjia mbi kontrollin e mësimdhënies, provimeve dhe kërkimit-shkencor. Nga dokumentet e depozituara nuk evidentohet një strategji e dedikuar për cilësinë, por, sikurse përmendur më lart, ajo është përkufizuar në mënyrë të përgjithshme në planin strategjik institucional. Rregullat për përfshirjen e studentëve dhe ekspertëve të jashtëm parashihen në statut dhe rregulloren e NjSBC-së. <i>Dok. (Plani i veprimtarisë NJSBC; Vendimi nr. 11, datë 28.09.2021 për miratimin e NJSBC).</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që	Nga dokumentet ngarkuara në portalin e ASCAL, konstatohen procedurat e aplikuara për licensim dhe akreditim konform ligjit për arsimin e lartë, si edhe instrumentet operacionale e taktike për garantimin e cilësisë. Nga dokumentacioni mbi detyrat e NjSBC-së dhe atë mbi vlerësimin, përcaktohen qartë detyrat dhe forma e pytësorit. Instrumenti që përdor UT, FE për sigurimin e cilësisë është “Manuali i Cilësisë” i cili specifikon parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në institucion në përputhje me kodin e cilësisë. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit. Në procesin e përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë janë të përfshirë si bashkëpunëtorë të

promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	jashtëm studentët e diplomuar dhe punëdhënësit. <i>Dok (035 Manuali i cilësisë)</i>			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit	Gjurmë të një politike të tillë, që normalisht i përket planit strategjik për cilësinë, nuk u gjetën në dokumentet e depozituara në ASCAL. Procedurat e ndjekjes dhe monitorimit periodik të cilësisë parashikohen në rregulloren përkatëse të NJSBC dhe letrat e punës të hartuara për këtë qëllim. Përsa i përket evidentimit në kulturën institucionale të cilësisë, nga vizita në terren konfirmohet niveli i mirë i saj në infrastrukturën logjistike, mbështetur në atë teknologjike dhe humane, niveli i kënaqshëm i saj në drejtimin akademik (literaturë, aplikim i teknologjisë në tema konkrete mësimore) dhe nivel mbi mesataren sa i përket hartimit të dokumenteve strategjike. IAL kryen anketime me studentet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjve të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngrre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Nga dokumentet e depozituara në ASCAL, specifikisht rregullore e NJSBC (neni 6) dhe (manuali i cilësisë), konstatohet njësi përgjegjëse për përmbushjen e kërkesave të këtij kriteri, është NjBSC. Kjo strukturë është ngritur me qëllim vlerësimin e brendshëm në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë. NJSBC ka si detyrë, organizimin e pyetësorëve anonimë 2 javë para mbylljes së çdo fund semestri, ku studentët kanë mundësinë të vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies. <i>Dok. (Rregullore e NJSBV, Manuali i Cilësisë, Pyetësori i studentëve).</i>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për	Nga konsultimi me stafin pedagogjik rezultoi se kishin mekanizma për vjeljen e informacionit mbi monitorimin periodik të syllabuseve. Gjithsesi, nga dosja e dokumenteve të ASCAL, <i>nuk konstatohen gjurmë konkrete se si realizohet ky proces. Nuk përmbahen të dhëna</i>

shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	<i>për këqyrjen e cilësisë së syllabuseve, por vetëm të mësimdhënies nga ana e pedagogëve.</i>			
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Nga konsultimi me bazën dokumentare të depozituar në ASCAL rezultoi se ka një pyetësor për studentët ku kanë mundësinë të shprehin mendimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies, për mënyrën e të shpjeguarit, format etj. Mënyra se si përpunohen të dhënat e NjBSC-së për matjen dhe vlerësimin përmes një sistemi vlerësimi të ecurisë së programeve të studimit mbledhen në fund dhe dalin për secilin pedagog. Konkretisht, nga pyetjet e drejtuara studentëve përmes pyetësorëve, vlerëson edhe aspektin akademiko-profesional. Në vlerësimin tabelar të përmbledhur në fund nuk i janë dhënë peshat përkatëse pyetjeve dhe as nuk konkludohet me një parametër agregat kundrejt syllabusit specifik, por vetëm kundrejt pyetjes specifike. <i>Dok. (Pyetësori i studentëve).</i>			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Referuar rregullores për Sigurimin e Cilësisë (neni 27) del në pah se raportet e NjSBC i përcillen drejtuesit të departamenteve drejtuesit të njësisë baze dhe Rektoratit. Trajtimi i rezultateve të tyre në institucion bëhet në nivel Rektorati, Dekanati dhe Njësie Bazë <i>Dok. (Rregullore e NJSBV, Manuali i Cilësisë).</i>			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	NJSBC organizon të paktën 2 herë në vit procesin e monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit. Këto raporte në vijim i komunikohen Drejtuesit të departamentit, Dekanit si dhe Rektorit. Me fillimin e pandemisë NJSBC nuk ka funksionuar dhe si të tillë nuk ka një raport final të ngarkuar në portalin e Ascal. <i>Dok. (Rregullore për sigurimin e cilësisë neni 27; Plani i veprimtarisë së NJSBC).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

101

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumenteve të përmendura në standartin më lart, vlerësimi nga NjSBC konstatohet se kryhet në mënyrë periodike për çdo semestër. Vetvlerësimi i brendshëm përfshin si aspektin e dokumentave rregullatore për të qënë koherent me planet strategjike të kërkimit shkencor po ashtu edhe vlerësimin nga ana e studentëve.</p> <p>Ky vlerësim nuk është përfshirë në bazën dokumentare të depozituar për akreditim në ASCAL. Referuar raportit të vlerësimit të brendshëm thuhet se këto raporte nuk janë realizuar për arsye të Covid-19. Vlerësimet paraprake për raportin e fundit janë kryer në shtator të 2021 ndërsa raporti final do të prodhohej në fund të vitit akademik 2021-2022. <u>Sugjerohet të publikohen raportet e Vetvlerësimit të Brendshëm.</u></p> <p><i>Dok. (Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, nenet 30-31).</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimeve, FEUT ka ndërthur disa metoda të niveleve të ndryshme. Konkretisht në nivel operacional: pyetësorë për studentët, inspektime dhe kontrole për mësimdhënien dhe testimin e studentëve; në nivel taktik: raportime tek drejtuesit, trajnime; në nivel strategjik: akreditime periodike. <i>Dok. (Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, nenet 12).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e ngarkuar në ASCAL, sikurse edhe nga takimet me stafin pedagogjik e studentët, konfirmohet vlerësimi i vazhdueshëm dhe periodik, direkt, për kërkesat e përmbajtura në këtë kriter. Sikurse theksuar më lart, <i>procesi vlerësues, nuk raportohet i plotë në dokumentet e depozituara në ASCAL.</i> Referuar pyetësorit që u bëhet studentëve fokusi më së shumti vendoset në aspektin akademiko-profesional.</p>

<p>auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program</p>	<p>Sikurse theksuar në kriterin 2 më lart, subjekti përdor pyetësorë e anketime për vjeljen e mendimeve të stafit akademik dhe të studentëve, sa i përket vlerësimit të dijeve dhe kompetencave të përftuara nga programi. Lidhur me punëdhënësit dhe institucionet e tjera, nga dokumentacioni i depozituar në ASCAL, nuk konstatohen sondazhe të kësaj natyre përveç atij të kryer në 09/06/2022 për studimin periodik për tregun e punës pas daljes së studentëve. <u>Sugjerohet që këto sondazhe të kryhen më shpesh.</u></p> <p><i>Dok. (Studimi periodik për tregun e punës pas daljes së studentëve; Pyetësori i studentëve).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret


Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

103



<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Kriteri 1 dhe 2 i standartit VI.1 më lart specifikojnë kërkesat për ekzistencën e politikave, procedurave dhe strukturave që do të dizenojnë dhe implementojmë garantimin e cilësisë. Konkretisht: Në përputhje me Ligjin 80/2015 (neni 103), VKM nr. 531, dt. 11.09.2018 statutin institucional, si edhe duke iu referuar aneksit 8.1 (Rregullorja e NJSBC) konstatohet se është ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe janë parashikuar rregullat e procedurat për funksionimin e saj. Në planin strategjik institucional gjenden politika të përgjithshme lidhur me cilësinë.</p> <p>Referuar dokumentacionit mbi aktivitetet e vazhdueshme të NJSBC-së konstatohen dokumentet tip për vjeljen e mendimeve të studentëve, raportet periodike mbi cilësinë dhe dokumentet tip të ushtrueshme mbi kontrollin e mësimdhënies, provimeve dhe kërkimit-shkencor. Nga dokumentet e depozituara evidentohet një strategji edhe dedikuar për cilësinë, por, sikurse përmendur më lart, ajo është përkufizuar në mënyrë të përgjithshme në planin strategjik institucional. Rregullat për përfshirjen e studentëve dhe ekspertëve të jashtëm parashihen në statut dhe rregulloren e NJSBC-së. <i>Dok. (Statuti i UT; Plani i veprimtarisë NJSBC; Vendimi nr. 11, datë 28.09.2021 për miratimin e NJSBC; Pyetësor i studentëve).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në nenin 12, të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë si dhe në dokumentit ku, cilësohet përbërja e NJSBC-së, ku përfshihen pedagogët dhe një student, në total 8 persona.</p> <p>Në rregullore (neni 30 dhe neni 31) përcaktohen qartë edhe përgjegjësitë e kësaj njësie. NJSBC ka përgjegjësinë dhe detyrën konkrete të monitorimit me qëllim përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë së programeve akademike në veçanti si dhe të FEUT në tërësi. <i>Dok. (Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, nenet 5-7; Rregullore e NJSBC).</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>Në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë dhe statutin institucional, njësia bazë propozon programin e studimit dhe stafin akademik për lëvrimin e saj tek studentët, sikurse edhe kuotat e kriteret pranuese në përputhje me kapacitetet. Këto kërkesa miratohen më pas nga njësia kryesore. Në bashkëpunim me kontrollet dhe raportimet periodike të NJSBC-së, stafi akademik dhe ai drejtues ndërmerr masat dhe korrektimet e duhura për mbarëvajtjen e cilësisë lidhur me programet e</p>

administrativ dhe studentët e programit të studimit.	studimit. <i>Dok. (Statuti i UT; Rregullore për Sigurimin e Cilësisë; Rregullore e NJSBC).</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga takimet me studentët, pedagogët, sikurse edhe me përfaqësues të NjsBC dhe drejtues të institucionit, nuk u konstatuan ankesa apo raportime në këtë drejtim. Njëkohësisht, nga baza dokumentare e depozituar nuk konstatohen elementë që të krijojnë dyshime për trajtim diskriminues në përfshirje dhe aktivizim sa i përket proceseve periodike vlerësuese. NJSBC synon dhe mbikëqyr arritjet e standardeve në bashkëpunim me të gjitha hallkat përgjegjëse të IAL, duke patur në fokus studentin. <i>Dok. (Rregullore e NJSBC).</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Sikurse theksuar më lart në kriterin 2, NjsBC e ka të përcaktuar në statut dhe rregulloren e saj, pjesëmarrjen e një eksperti të jashtëm, nga 8 në total të parashikuar. Referuar vendimit nr.11 datë 28.9.2021 për miratimin e përbërjes së NjsBC është e pamundur të identifikohet cili është eksperti i jashtëm, ndër 7 anëtarët e paraqitur si anëtarë të NjsBC. <i>Dok. (Rregullore e NJSBC; Vendimi nr.11 datë 28.9.2021 për miratimin e përbërjes së NjsBC).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike	Nga konsultimi Statuti i UT-se dhe rregullores për Sigurimin e cilësisë të FEUT konstatohet se NjsBC nuk ka një faqe të dedikuar për të, ku të jenë pasqyruar në mënyrë transparente raportet e sigurimit të cilësisë ndër vite. Në këtë hapësirë virtuale nuk gjenden dokumente të strategjive dhe politikave në këtë drejtim. Edhe nga dokumentet e depozituara në ASCAL mungon

për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	një plan strategjik i mirëfilltë për cilësinë, por elementë të rregullimit të saj gjenden në statut, plan strategjik institucional dhe rregulloren e NjsBC-së. <i>Dok. Statuti i UT; Rregullore Për Sigurimin e cilësisë).</i>		
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Vlerësimi kryhet në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese. Struktura drejtuese i përcjell rezultatet në njësinë bazë dhe ato elemente që lidhen me këtë njësi. Nga dokumentet e depozituara në dosjen e ASCAL, nuk ka informacion nëse raportet e NJSBC-së, janë të aksesueshme për stafin apo studentët. <i>Sygjerohet që përmbledhjet e rezultateve të raportit dhe masave propozuese, të bëhen publike dhe të aksesueshme si për stafin akademik ashtu edhe për studentët.</i>		
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nga dokumentet e depozituara, sikurse edhe nga inspektimi online i webfaqes, mungon analiza dhe plani i masave për korrektimin e të metave dhe plotësimin e mangësive.		
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në mungesë të një analize të thelluar dhe plani respektiv masash, nuk mund të sigurohet efektiviteti dhe impakti për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë.		
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk gjenden gjurmë të veprimtarive të tilla.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Kontabilitet dhe Auditim”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. FEUT/Departamenti i Kontabilitetit ka një staf të shkëlqyer akademik, me tituj dhe grada shkencore, të kualifikuar dhe me eksperiencë akademike, si edhe profesionistë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, të nevojshme për këtë program studimi;
2. FEUT disponon infrastrukturën e nevojshme fizike dhe laboratorike për të realizuar sa më mirë procesin e mësimdhënies dhe praktikave mësimore për studentët e këtij programi studimi;
3. FEUT ka marrëveshje me një sërë institucionesh dhe organizata publike si dhe kompani apo biznese private për të mundësuar kryerjen e praktikave profesionale të studentëve si dhe punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve;
4. FEUT ka marrëveshje me shumë universitete të huaja, duke mundësuar mobilitete për stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi në kuadër të programeve Erasmus +;
5. Biblioteka e FEUT (Hardcopy dhe elektronike), siguron dhe plotëson kërkesat e stafit akademik dhe studentëve me literaturën bazë dhe ndihmëse për nevojat e procesit mësimor si dhe kërkimin shkencor;

b. Pika të dobta:

1. Nuk ka një studim të mirëfilltë të tregut të punës nga FEUT, në lidhje me zhvillimet aktuale dhe ato të pritshme në vendin tonë, me qëllim identifikimin e nevojave dhe kërkesave të tregut të punës lidhur me punësimin e studentëve; (*Standardi I.3, Kriteri 2*).

Rekomandime

1. Të bëhen studime tregu parësore (nga vetë institucioni/FEUT) për të identifikuar sa më mirë kërkesat dhe nevojat e tregut të punës, me qëllim garantimin e punësimit të studentëve të diplomuar;
2. Nga ana e FEUT-së, të përditësohet dokumentacioni dhe rregulloret përkatëse në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

3. Nga ana e strukturave përkatëse të FEUT, të tregohet kujdes dhe saktësi në ngarkimin e dokumentacionit përkatës në faqen e ASCAL-it, lidhur me akreditimin e këtij programi studimi;
4. Për këtë program studimi, rekomandohet të rishikohet shpërndarja e lëndëve në planin mësimor për vitin e parë dhe të dytë në raportin 60:60 kredite;
5. Dega e Burimeve Njerëzore, të përditësoj dhe plotësoj me dokumentacionin e nevojshëm, dosjet e stafit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme;
6. Sekretaria mësimore të plotësojë dokumentacionin përkatës (rregjistrat themeltar) me të gjitha të dhënat e studentëve në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas udhëzimeve të MAS;
7. Zyra e Karrierës dhe Alumnit, të mbaj kontakte të vazhdueshme lidhur me gjurmimin/ndjekjen e studentëve të diplomuar rreth punësimit dhe karrierës së tyre profesionale;

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in "Accounting and Auditing"

a. Strengths and Affirmations:

1. FEUT/ The Department of Accounting has an excellent academic staff, with scientific titles and degrees, qualified and with academic experience, as well as professionals in the field of accounting and auditing, necessary for this study program;
2. FEUT has the necessary physical and laboratory infrastructure to conduct the teaching process and teaching practices for the students of this study program as best as possible;
3. FEUT there are agreements with a number of public institutions and organizations as well as private companies or businesses to enable the professional practice of students, as well as their employment after completing their studies;
4. FEUT there are agreements with many foreign universities, enabling mobility for the academic staff and students of this study program within the Erasmus programs +.;
5. The library of FEUT (Hardcopy and electronic), provides and fulfills the requirements of academic staff and students with basic and auxiliary literature for the needs of the teaching process as well as scientific research;

b. Weak points:

1. FEUT does not have a proper study of the labor market in relation to the current and expected developments in our country, to identify the needs and requirements of the labor market regarding the employment of students; (*Standard I.3, Criterion 2*).

Recommendations

1. Conduct primary market studies (by the institution itself/FEUT) to better identify the demands and needs of the labor market, in order to guarantee the employment of graduated students;
2. FEUT to update the relevant documentation and regulations in accordance with the legal and by-laws in force;
3. The relevant FEUT structures must show care and accuracy in uploading the relevant documentation on the ASCAL website, related to the accreditation of this study program;
4. For this study program, it is recommended to review the distribution of subjects in the curriculum for the first and second year in the 60:60 credit ratio;
5. Human Resources Office, to update and complete with the necessary documentation the files of full-time and part-time academic staff;
6. The teaching secretariat should complete the relevant documentation (basic registers) with all student data in accordance with the criteria defined according to the MES instructions;
7. Career and Alumni Office, to keep in constant contact for the tracking/follow-up of graduate students on their employment and professional career;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X